Rruga e Arbërit

Botim Periodik i Shoqatës "Lidhja e Intelektualëve Dibranë". Viti II i Botimit. **Nr. 5(13).** **Maj 2007** Çmimi: **50** lekë

"Tre Dibrat"
Dibranët po sfidojnë kohën

Nga Rexhep TORTE
Dibër

Vitaliteti i pamohueshëm i shqiptarëve dëshmohet më së miri nëpërmjet dibranëve, që karakterizohen përmes tre Dibrave. E para: Dibra e Madhe dhe kryeqendra e Krahinës së Dibrës deri në vitin 1913, kur me Konferencën e Ambasadorëve në Londër në vitin 1913 dhe me Konferencën e Paqes në Paris 1919-'20, iu dhurua Beogradit dhe sot ndodhet në Maqedoni. E dyta: Dibra e Vogël, e cila mbeti në gjirin e Shqipërisë dhe e treta, një Dibër e tërë mërgimtarësh që tashmë gjendet në SHBA.

HISTORI E LAVDISHME, POR E DHEMBSHME

Dibra, me një histori të begatë e të lavdishme, me çdo pëllëmbë tokw të larë me gjakun trimëror të burrave e grave, gjithnjë për të mbrojtur nderin, veten, fëmijët dhe pragun e shtëpisë, ka mbetur sinonim i fjalës dhe besës, i urtësisë dhe pushkës.

Edhe pse e shkatërruar, e kafshuar, e tradhëtuar dhe e djegur shumë herë gjatë shekujve, Dibra me njerëzit e saj gjithnjë kanë gjetur mundësinë të sfidojnë e të hedhin shtat, sikur lisi në pyll të shkrumuar.

Krahina e Dibrës, me pozitën e saj gjeostrategjike, me dibranët trima të Nëntë Maleve, që kanë penguar mësymjet grabitqare të të huajve për të okupuar bregdetin shqiptar, ka qenë cak i sulmeve të fuqishme e të njëpasnjëshme grabitqare.

Vrasjet, gjëmat dhe vuajtjet më tmerruese në Krahinën e Dibrës i kanë bërë serbët. Shfletimi i faqeve dhe ngjarjeve të historisë flet për një gjenocid shfarrosës të përmasave të paimagjinueshme. Serbët gjakpirës Krahinën e Dibrës e kanë djegur tri herë, duke detyruar shpërnguljen e dhjetëra mijërave dibranëve. Doktrina e tyre luftarake ka qenë fatale, shkrumbuese dhe shfarrosëse.

(Vijon në faqen 6)

RRUGA E ARBËRIT - RRUGA QE I MUNGON KOMBIT

Kuvendi tekniko - shkencor për "Rrugën e Arbërit" - ide për zhvillimin e Shqipërisë



"RRUGA E ARBERIT", e plotëson më mirë perspektivën dhe nevojën për shkurtimin e distancave dhe lidhjen e një rajoni të tërë me rrjetin rrugor nacional e ndërkombëtar.

SPECIALE NE FAQET 2 - 5

RRUGA E ARBËRIT NË TERRITORIN E MAQEDONISË: DIBËR – GOSTIVAR – TETOVË - SHKUP

Nga Inxh. SHEFKI ALITI*

Në stadin e sotëm te zhvillimit, ka lindur si nevojë imediate ndërhyrja në infrastrukturën rrugore të Ballkanit Perëndimor në përgjithësi, dhe të Maqedonisë Perëndimore e Shqipërisë në veçanti, për të ndërmarë një sërë projektesh për ndërtimin e autostradave si dhe ndërtimin e tyre që janë të lidhura ngushtë me domosdoshmërinë e zhvillimeve rrugore-infrastrukturale të Republikës së Maqedonisë, me theks të veçantë, në pjesën perëndimore të saj, e Shqipërisë kryesisht ne pjesen veri lindore te saj për lidhshmërinë e ekonomisë, qyteteve, regjioneve ekonomike si dhe shteteve ballkanike, që do të kontribuojnë në ringjalljen e ekonomisë si dhe zhvillimin parimor në përgjithësi.

(Vijon në faqen 4)

Si e kujtoj unë "Rrugën e Arbërit"

Shkruan nga SHBA, AGIM KABA

FAQE 5

Prof.Dr. Nuri Abdiu boton "Psikologjia e Hasan Tahsinit"

Një vepër dinjitoze për historinë e mendimit psikologjik



Prof.Dr. **VEHBI HOTI**

FAQE 8

XHAFER MARTINI BOTONTË RIPUNUAR "KANUNI I DIBRËS"

GJENEZA E CIVILIZIMEVE KANUNORE

Nga **AGRON TUFA**

FAQE 10

VISARE NGA ODA DIBRANE / FJALË NË SEPETE

Mos e fut drithin në thes të huej

Nga **NAIM PLAKU**

FAQE 11

KUVENDI TEKNIKO - SHKENCOR PËR "RRUGËN E



Ura e Hoxhës në Gurë të Bardhë

"RRUGA E ARBËRIT, RRUGA KRYESORE E VENDIT, KRAHAS RRUGËS EGNATIA QË NË LASHTËSI"

Prof. Dr. VALTER SHTYLLA

Rruga e vjetër Durrës - Fusha e Tiranës - Dibër

Pozita e përshtatshme gjeografike e trojeve tona, që prej kohëve më të vjetra ka përshtatur trasimin në to të shumë rrugëve të njohura në histori. Më e njohura ka qenë *Via Egnatia* e shekullit II p.e.s e ndërtuar nga romakët, e cila nga Durrësi – Elbasani - Ohri e Selaniku shkonte në Konstandinopojë.

Veç Egnatias, nga Durrësi drejt brendësisë niseshin dhe rrugë të tjera që degëzoheshin në fushën e Tiranës, siç kanë qenë ajo Durrës – Lissus - Naissus, rruga Tiranë – Krrabë - Elbasan, degë e Egnatias, etj. Veç këtyre nëpër Tiranë kalonte dhe rruga e detit për në Dibër, e njohur me emrin "Rruga e Arbërit". "Rruga e Arbërit" ka origjinën nga periudha Romake, Shekulli i I dhe II, siç dëshmojnë stacionet rrugore "Mansion" (Mansaj) të Gurit të Bardhë. Në shekullin XI, rruga përmendet nga kronistja britanike Ana Komnena, ndërsa në vitin 1257 këtej kaloi komandanti britanik Gjergj Akropolit. Normanet e Boemundit kalonin në këtë rrugë gjatë luftimeve. Në defterin turk të 1467-ës Guri i Bardhë etj. përmenden si fshatra "Dervene" që ruanin e mirëmbanin rrugën. Stacione të rëndësishme të rrugës kanë qenë Zall-Dajti në malësinë e Tiranës dhe Guri i Bardhë.

Në këto fshatra ndodhen mjaft gjurmë të rrugës si hane, karakolle, kalldrëme, ka shumë ura, etj.

Rruga Tiranë-Dibër nga Guri i Bardhë është varianti më i shkurtër që lidh këto qytete, prandaj projektuesit e sotëm po studiojnë ndërtimin e kësaj traseje ekonomike.

ORGANIZATORËT E KUVENDIT

KOMISIONI QENDROR ORGANIZUES
1. Nuri Abdiu, Kryetar
2. Bashkim Lleshi, Zv/Kryetar
3. Iljaz Kaca, Anëtar
4. Shpetim Cami, Anëtar
5. Rakip Suli, Anëtar
6. Musa Riçku, Anëtar
7. Shaban Bitri, Anëtar
8. Preng Doci, Anëtar
9. Shaqir Skarra, Anëtar

KOMISIONI TEKNIKO – SHKENCOR
1. Faruk Kaba, Kryetar
2. Bashkim Lleshi, Zv/Kryetar
3. Avni Dibra, Anëtar
4. Ilir Alliu, Anëtar
5. Vesel Hoxha, Anëtar
6. Naim Karaj, Anëtar
7. Tefik Jegeni, Anëtar

SEKRETARIA E KUVENDIT
1. Bujar Karoshi
2. Hysen Uka
3. Ilir Strazimiri

SPONSORËT E KUVENDIT

"Aurora Group" - Rakip Suli
"Usluga CO" - Sadri Abazi
"Riçku" Sh.p.k - Musa Riçku
"Almo Konstruksion" - Shaban Bitri
"Erdat" Sh.p.k - Preng Doçi
"Hotel Edisem" - Muhamet Bitri
"Dimension '06" - Bashkim Kamberi
"Dita 2000" - Naim Buci
"Ital Pamelli" - Demir Rusi
"Pro Gips - Knauf" - Uzri Hoxha
"Bruçi" Sh.p.k. - Faik Bruçi
"Diamant" Sh.p.k. - Zaim Korsi
Qendra "Franklin" - Shpëtim Cami
Botimet "m&b" - Bujar Karoshi
Butik "Cibaku" - Shkëlqim Cibaku
Shkolla "Sarina 2002" - Liman Hoxha
"Euroreklama Korabi" - Afrim Çenga
Klinika Dentare "Methasani" - Bujar Methasani

KËSHILLI BOTUES I GAZETËS

Drejtor: **RAKIP SULI**
Kryeredaktor: **SHAQIR SKARRA**
Redaksia: **Hajri Mandri, Prof. Dr. Bashkim Lleshi, Prof. Dr. Shaban Sinani, Bujar Karoshi, Dukagjin Hata, Dr. Hasan Leka, Mirvet Lala**

ADRESA E GAZETËS: Blloku i banesave "Gintash", Laprakë.
Tel.068 31 19 232. Tel: (04) 357 179.
E-mail: lid_gazeta@yahoo.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin qëndrimin e redaksisë dhe Shoqatës "LID".

Shoqata "Lidhja e Intelektualëve Dibranë", **PROCREDIT BANK**. Nr. Llog:
Në lek 13-661344-0001.
Euro 13-661344-0102.
USD 13-661344-0203.

PËRMBLEDHJE E STUDIMIT TË FISIBILITETIT

STUDIM PËR MUNDËSINË E NDËRTIMIT TË RRUGËS SË ARBËRIT

Dr. Inxh. Faruk KABA
Inxh. Piro BEDO
Prof. Dr. Bashkim LLESHI
Inxh.Tefik JEGENI
Dr. Orhan SAKIQI,
Msc. Ekon. Edmond ALITE

Sipas burimeve historike dhe të Institutit të Monumenteve të Kulturës, kjo rrugë daton që në lashtësi ashtu si dhe Via Egnatia, madje mund të konsiderohet si pjesë apo degë e saj. Rruga përmendet dhe trajtohet me interes në "Historia e rrugëve të Shqipërisë" të Josif Adhamit dhe në punime të Prof. Valter Shtyllës.

E gjithë rruga si në lashtësi edhe në Mesjetë ka qenë shoqëruar me disa vepra arti si, Urat me hark të Spiles, Zerqanit, Vashës, Brarit etj. me karakolle (pika) kontrolli e hane pothuajse gjatw gjithë aksit të saj.

Këto tregojnë që ky arter ka qenë mjaft i vozitur në lashtësi dhe veçanërisht në Mesjetë kur u rinovua nga Venedikasit dhe më tej deri vonë në ditët tona, i përdorur nga banorët e këtyre trevave si rrugë këmbësore dhe me karvanet, pra me një histori shume të hershme.

Nga llogaritjet e bëra rezulton se nga kjo rrugë, për të shkuar në Klos, Bulqizë, Peshkopi, Dibër të Madhe nga Tirana apo Durrësi shkurtohen distanca të konsiderueshme në krahasim me rrugen nacionale ekzistuese që funksionon sot dhe që kalon nga Tirana në Milot, Burrel, Klos e me tutje në Bulqizë, Zerqan, Shupenzë e së fundi në Dibër.

Nga kryerja e studimit të fisibilitetit, ku u krahasuan tre variante, jo rastësisht, varianti më i mirë e më i leverdisshëm, rezultoi ai sipas aksit të Rrugës së vjeter të Arbërit, variant i studjuar dhe i përdorur që në kohët e hershme.

Varianti më i mirë dhe më i leverdisshëm rezultoi varianti i dytë sipas

"RRUGA E ARBERIT", e plotëson më mirë perspektivën dhe nevojën për shkurtimin e distancave dhe lidhjen e një rajoni të tërë me rrjetin rrugor nacional e ndërkombëtar.

aksit: **TIRANË – ZALLDAJT – MURIZË – GURI I BARDHE – URA E VASHËS – PLANI I BARDHË – BULQIZË – URA E ÇERENECIT – GJORICË – DIBËR.**

Ndërtimi i Rrugës sipas këtij varianti shkurton në mënyre të ndjeshme distancat e transportit që lidhin Tiranën dhe Portin e Durrësit me Dibrën, Peshkopinë, Matin, Shkupin dhe trevat e tjera në Maqedoni, Sofjen, etj.

Ky variant mund të vlejë shumë mirë si alternativë mjaft kompetitive e Korridorit të 8te paneuropian.

Varianti i dytë i shmanget në mënyrë të ndjeshme lartësive mbi 900 m mbi nivelin e detit, që do ta bënin këtë rrugë të vështirë për t'u vozitur gjatë periudhave të gjata e të vështira të dimrit dhe tepër të vështirë për t'u mirëmbajtur, si dhe është varianti me kushte më të mira gjeologo-inxhinjerike e hidrologjike.

Përfundimisht Konsulenti është për zgjidhjen e DYTE, pikërisht për atë që quhet varianti apo **"RRUGA E ARBERIT",** e cila plotëson më mirë perspektivën dhe nevojën për shkurtimin e distancave dhe lidhjen e një rajoni të tërë me rrjetin rrugor nacional e ndërkombëtar.



Lugina e Matit pranë Urës së Vashës. Në këtë vend kalon aksi i rrugës së re

AKSI I RRUGËS SË ARBËRIT:

TIRANË – ZALLDAJT – MURIZË – GURI I BARDHE – URA E VASHËS – PLANI I BARDHË – BULQIZË – URA E ÇERENECIT – GJORICË – DIBËR.

ARBËRIT" - IDE PËR ZHVILLIMIN E SHQIPËRISË



Vendburimi i kromit Bulqizë

PASURITE MINERALE TË RAJONIT TË DIBRËS QË MUND TË VIHEN NË QARKULLIM EKONOMIK, ME NDËRTIMIN E RRUGËS SË ARBËRIT

Dr. Vesel HOXHA
Prof.Dr. Bashkim LLESHI
Prof. Dr. Ilir ALLIU
Inxh. Sefedin SHABANI
Dr. Naim KARAJ

Në rajonin e Dibrës takohen shumë vendburime, objekte e shfaqje të mineraleve të dobishme metalore e jo metalore

Minerali i kromit përbën një nga pasuritë më të mëdha që gjendet në rajonin e Dibrës. Atë e takojmë në masivet ultrabazike perspektivë lindore të vendit tonë në atë të Bulqizës dhe të Lurës.

Në masivin Bulqizës janë zbuluar vendburimet më të mëdha të kromit siç janë: vendburimi **Bulqizë - Batër, Qafë - Buall, Almarinë, Tërnovë, etj.**

Në pjesën veriore gjenden disa objekte kromi siç janë: objekti **Zabeli, Majat e Bregut, Kodra e Lerës, Fushë-Balgjaj, Kepat e Dik-Nelit, Liqeni i Dervishit, Selishta veriore, Selishta jugore, Bataçet e Kacnisë, Fushë Shtrungëza, Rrënja e Milloshit, Maja e Hurdhës, Druni i Boshtive, Qaf –Murra,** etj.

Në masivin e Lurës janë kryer më pak punime të kërkim-zbulimit e megjithatë janë zbuluar disa objekte e shfaqje të mineralizuara kromi si në **Krej Lurë, Kesule, Blac, Kumbull, Lajthize, Dodaj, etj**.

Në rajonin e Dibrës janë zbuluar edhe disa minerale të tjerë metalorë si **Minerali i Manganit** në Topojan e në Zonën e Gollobordës, **minerali i Hekurit pa nikel** në zonën e Korabit, **Minerali i bakrit** në Zonën e Pregj Lurë - Arrmollës dhe të Peshkopisë (Pilafe, Zimur, Cerjan), **Minerali i Hekur-Nikelit** në zonën Lajthizë-Nome, shfaqje e **shenja të arsenik-polimetaleve** në zonën e Dipjakës e Radomirës dhe shenja të **mineraleve të rrallë e të çmuar** për të cilët nevojiten punime e studime të mëtejshme.

Rajoni i Dibrës është i pasur edhe me minerale e shkëmbinj industriale jo metalore, shumë të rëndësishëm për ekonominë e tregut si: Gurët dekorative karbonatike dhe ofiolitike e mermeret, shkëmbinjtë gelqerore si lëndë e parë ndërtimi për prodhimin e inerteve karbonatike, gëlqeres e çimentos, të Gjipseve e anhidriteve si lëndë e parë ndërtimi për prodhimin e parafabrikateve të gjipsit, allçisë, çimentos së bardhë, etj., Argjilat si lëndë e parë ndërtimi për prodhimin e tullave, qermikës, e çimentos, Ranorëve, Kuarciteve, Travertinave, Inerteve lumore e shkëmbore (karbonatike), Bojrave të dheut, Pirofilitit, Squfurit, kryprave minerale në evaporitet, grafiteve, shapeve, rrasave, etj.

Hapja e Rrugës së Dibrës do të bëjë që të vihen në qarkullim ekonomik dhe me efektivitet vendburime të njohura të Kromit, vendburimet e evaporiteve (gjipseve), argjilave, meremereve, bojrave të dheut, travertinave, etj. Burimet ujore të freskëta, squfurore, për të pirë e për prodhimin e Energjisë si dhe do ti japë një hop të mëtejshëm zhvillimit të turizmit e vlerësimit të mëtejshëm të Gjeomonumenteve të këtij rajoni.

RRUGA E ARBËRIT DHE RESURSET NATYRORE TE RRETHIT TE MATIT

Nga Msc. Inxh. Agim SHENJATARI

Rruga e ARBËRIT në lashtësi

Ky arter i rëndësishem rrugor pararomak lidhte detin dhe përtej-detin me lindjen Europiane. Për rëndësinë e madhe të kësaj rruge në zhvillimin e tregëtisë, flasin dy marrëveshje të vjetra: e para në fillim të shekullit të XIII, ku Dhimitri "Princ i madh i Arbërit" u garanton raguzianëve "kalim të lirë në tokat e tij", pra nëpër shtetin e Arbërit dhe e dyta është e vitit 1429 firmosur nga Gjon Kastrioti dhe bijtë e tij, me të cilën u sigurohej gjithashtu tregëtarëve raguzianë "kalim i lirë nëpër tokat e Kastriotëve", e më tej.

Degëzimet e Rrugës së Arbërit në Mat

Qafa e Murrizës e vendosur në jug-perëndim të luginës së Matit, në kufi me Zall Dajtin, përbënte pikën kyçe të lidhjes së ultësirës perëndimore pranëadriatike me pjesën lindore e verilindore të vendit. Nga qafa e Murrizës kalonin dy rrugë:

Qaf Murrizë – Guri i Bardhë–Ura e Vashës–Plani i Bardhë–Qaf Buall–Bulqizë .... Shkup.

Qaf Murrizë – Qafë Shkallë – Klos.

Në Klos kemi ndarjen në tre drejtime :

Klos (Dars) – Ura e Halilit – Bel Unjatë – Gurrë (Krahu perëndimor i luginës së Matit).

Klos – Suç – Shoshaj – Urakë – Perlat .... Shkodër.

Klos –Ura e Allamanit – Cëruje – Patin, me dy variante.

Varianti veror: Patin – Qaf Dardhë – Qaf Mesi – Qaf Murrë

Varianti dimëror: Patin – Kurdari – Gjalish – Lis – Qaf Murrë

Këto variante mbi dymijë vjeçare, të shoqëruara me ura, kala, karakolle, kalldrëme ruhen pjesërisht deri në ditët e sotme. Rruga eArbërit ka patur aktivitet deri në vitet '60.

Sot ajo shfrytëzohet nga banorët e Xibrit, Gurit të Bardhë si varianti më i shkurtër me Tiranën dhe Durrësin.

Rruga e Arbërit dhe tregjet në Mat

Pasuritë minerale: Krahinat e Matit dhe Martaneshit e më tej, janë të njohura për pasuritë e mëdha industriale që zotërojnë. Kështu, përllogariten në disa dhjetëra milionë ton rezervat prognozë të oksidit të kromit (Cr_2O_3), në disa dhjetëra milionë m^3, rezervat e mermereve e gëlqerorëve të mermerizuar, gelqerorëve pllakorë, argjilave industriale, materialeve të ndertimit, bimëve industriale e medicionale etj.

Venburimet kryesore të kromit ndodhen në Shkallë–Qaf Burreli-Manazdre, Batër - Lugu i Gjatë - Thekën (Martanesh), por dhe rezervat gjeologjike prognozë të përllogaritura nga specialistët e fushës, ndodhen afër dhe rreth këtyre vendburimeve të njohura.

Gëlqerorët e mermerizuar të Triasit të sipërm, gëlqeroret pllakorë të Triasit të mesëm, ranorët pllakorë të Kretë-paleogjenit, ndodhen në rajonin Xibër-Llapush-Qaf Shtamë, **Mineralet sulfidë të bakër-nikelit** ndodhen në rajonin Qaf Dardhë-Cërujë-Shahinaj, Staveç-Krastë.

Argjilat industriale ndodhen në Shoshaj dhe Shëngjun.

Ndërtimi i Rrugës së Arberit do të fuqizojë dhe vejë në lëvizje këto pasuri të rëndësishme minerale në dobi të ekonomisë së tregut.



Impianti i seleksionimit të kromit Klos



Kanjoni i lumit të Tiranes tek Ura e Brarit

Rruga e Arbërit - Premisë për zhvillimin e turizmit

Prof. Dr. Bashkim LLESHI
Inxh. Avni DIBRA

Rruga e Dibrës, e quajtur "Rruga e Arbërit", rrugë aq e pasur me histori, parashikohet të jetë një ndër rrugët më të bukura turistike në trevat shqiptare. Rruga e Arbërit, vetëm 75 km e gjatë, do të lidhë Tiranën me Dibrën e Madhe (Maqedoni). Rruga parashikohet të përshkohet me shpejtësi mesatare 80 km/orë, duke mënjanuar në maksimum ngjitjet malore, edhe se përgjatohet ose ndërpret vargmale me lartësi mbi 1500-2000 m., nga më të bukurit të vendit, si ajo Krujë-Dajt, Malin me Gropa dhe të Bulqizës.

Rruga e Arbërit fillimin e saj e ka në qendrën e Tiranës, në sheshin „Skënderbej", vijon nëpër qytet përgjatë "Rrugës së Dibrës„ për të arritur në Brar dhe kaluar shkallën e Tujanit, luginën e bukur të Brarit, në luginën e ngushtë e të thellë të malit të Dajtit, me kanionet mahnitës të ngushtë e të thellë. Rruga përshkon luginat malore të Shpalit, Murrizës, kapërcen me tunel në veri të Qaf Murrizës nga ana e Tiranës, duke dalë në anën e Matit në luginat e bukura malore të Xibrit e Gurit të Bardhë, në grykën e rrjedhjes së sipërme të lumit të Matit mbi Urën e Vashës dhe pasi kalon luginën e Planit të Bardhë dhe tunelin e Qafës së Buallit, del në luginën e mirënjohur të Vajkalit, Zallit të Bulqizës, Zerqanit deri sa del në fushën e Gjoricës të pellgut të Dibrës dhe për të vazhduar deri në Dibër të Madhe.

Hapja e kësaj rruge, do të krijojë kushte për lëvizje të mëdha. Rruga do të shërbejë për zhvillimin e trevave verilindore të Shqipërisë dhe trevave shqiptare në Maqedoni, duke i dhënë një impuls të madh zhvillimit të turizmit, si dhe do të krijojë lehtësira të lëvizjes së turistëve për në bregdetin shqiptar. Rruga më tej, pas Dibrës së Madhe, do të kalojë nëpër grykën e Radikës në krah të së cilës ngrihen shpatet jugore të vargmalit të Kërçinit, vazhdon deri në afërsi të qafës së Mavrovës, ku arrin në Kompleksin turistik të Mavrovës. Rruga e Arbërit, duke u bashkuar me rrugën Strugë – Gostivar, arrin në Shkup dhe, distanca Tiranë–Shkup shkurtohet rreth 100 km.

RRUGA E ARBËRIT NË TERRITORIN E MAQEDONISË:

DIBËR – GOSTIVAR – TETOVË - SHKUP

(Perspektivat e zhvillimit të infrastrukturës në Maqedoninë perëndimore)



Rruga për Mavrovë nëpër Luginën e Radikës. Foto: Gazmend Kërkuti

Nga Inxh. SHEFKI ALITI*

Në stadin e sotëm te zhvillimit, ka lindur si nevojë imediate ndërhyrja në infrastrukturën rrugore të Ballkanit Perëndimor në përgjithësi, dhe të Maqedonisë Perëndimore e Shqipërisë në veçanti, për të ndërmarë një sërë projektesh për ndërtimin e autostradave si dhe ndërtimin e tyre që janë të lidhura ngushtë me domosdoshmërinë e zhvillimeve rrugore-infrastrukturale të Republikës së Maqedonisë, me theks të veçantë, në pjesën perëndimore të saj, e Shqipërisë kryesisht ne pjesen veri lindore te saj për lidhshmërinë e ekonomisë, qyteteve, regjioneve ekonomike si dhe shteteve ballkanike, që do të kontribuojnë në ringjalljen e ekonomisë si dhe zhvillimin parimor në përgjithësi.

Në rajonin e Ballkanit, gjithsesi paraqitet si nevojë, të ndërlidhen në mes tyre qytetet dhe regjionet (në aspektin ekonomik), me autostradë bashkëkohore me çka do të kontribuohet në zhvillimin më të shpejtë ekonomik, kulturoro-gjeografikë dhe bashkëpunimin e ndërsjelltë politikë, si dhe ndërlidhshmërinë e shteteve në mes tyre me qendra të fuqishme ekonomike, gjegjësisht regjione me kapacitete për ekonomi zhvillimore.

Në kontekst të kësaj, është propozuar të bëhet përpilimi i një projekti ideor dhe projekti bazë, për ndërtimin e një autostrade moderne dykahshe ndërmjet qytetit Tetovë dhe kalimit kufitar Jazhincë, në kufirin Maqedoni-Kosovë, me gjatësi rrugore – autostradë L=28 km.

Kjo autostradë është e nevojshme të projektohet dhe ndërtohet në suaza të rrugës ekzistuese e cila i ndërlidh të gjitha katundet e regjionit në fjalë. Në autostradën e re është e nevojshme të ndërtohen katër unaza me të cilat do të ndërlidhen katundet Leshkë, Tearcë, Dobroshtë dhe Vratnicë.

Autostrada e më sipërme do të ndërlidhë në mes tyre rajonet e Maqedonisë Perëndimore dhe tërë Maqedonisë me Kosovën, sidomos në aspektin ekonomik, për shkak se Kosova paraqet regjionin më të pasur me minerale te dobishme metalorë e jo metalorë, përkatësisht zen vendin e dytë ne Europë me rezerva të mineralit të lignitit dhe me xeherorët e plumbit dhe të zingut, të kombinatit "Trepça".

Autostrada në fjalë, njëkohësisht do të shërbente si lidhje rrugore më e shkurtër për ndërlidhjen e shteteve, regjioneve dhe qyteteve Prishtinë, Han i Elezit, Tetovë, Gostivar, Dibër, Peshkopi, Bulqizë, Tiranë, Durrës (Detin Adriatik) dhe më tej me Italinë, Malin e Zi dhe kështu me gjithë Europën.

Autostrada e preferuar i lidh në mes tyre edhe qendrat e fuqishme ekonomike në Kosovë dhe Mitrovicë (të pasura me lignit, plumb dhe zink), Tetovën me kombinatin "SILMAK", i cili prodhon ferosilicium dhe silicium-metal, fabrikën e "Teteks"-it dhe fabrika të tjera, pastaj fabrikën për përpunimin e lëndëve rezistuese në temperatura të larta (tulla refraktare) "Haznedar", e cila e ka filluar prodhimin e saj para pak kohësh (gjegjësisht fabrika e dikurshme "Silika") në Gostivar, fabrika për përpunimin e qelqit në Gostivar, si dhe shumë fabrika të mëdhaja që gjenden në këtë rajon.

Fabrika gjermane "Kanuf-Radika" në Dibër, me xeheroren më të njohur të gjipsit në Ballkan, bashkë me regjionin e Peshkopisë, Bulqizës dhe të Burrelit, të cilët e kanë uzinen për ferokrom si dhe minierat për nxjerrjen e tij, paraqesin sfidën më të madhe plotësuese për të nxitur edhe më shumë zhvillimin e këtij rajoni dhe ndërtimin e infrastrukturës rrugore për zhvillimin ekonomik dhe industrial të kësaj pjese të Europës Juglindore, paraqet në formë plotësuese nevojën dhe arsyeshmërinë për një projekt të tillë.

Ndërtimi i autostradës, që do t'i ndërlidhë këto qytete dhe rajone të lartpërmendura, bashkë me Kryeqytetin e Shqipërisë, Tiranën gati njëmilionëshe, i cili lidhet me qytetin bregdetar Durrës, i cili si portë detare hyrëse e "Koridorit te 8te" duhet zhvilluar në përmasa botërore.

Njëkohësisht paraqitet nevoja e domosdoshme edhe për ndërtimin e autostradës prej Gostivari në drejtim të Mavrovës dhe prej pjesës së ndërlidhjes rrugore i cili ndahet nga rruga Gostivar-Kërçovë drejt Mavrovës, ku prej asaj pike duhet të vazhdojë autostrada për në Leunovë, drejt terreneve sportive në Bistra dhe Mavrovë, që do të kalojë afër Galiçnikut që ndërlidhet me vendin "Boshkovmost" gjer në Dibër.

Ndërtimi i këtij kompleksi rrugor si variant është më i arsyeshëm dhe më i shkurt në krahasim me variantin e "Koridorit 8te", i cili është i paraparë të kalojë përafër qyteteve Gostivar-Kërçovë-Strugë-Qafa e Thanës në Shqipëri.

Përparësitë për ndërtimin e këtij kompleksi rrugor, në drejtim të vendbanimeve Leunovë-Mavrovë-Dibër, janë shumë të mëdhaja për shkak se, traseja rrugore është shumë më e shkurtër dhe më e shpejtë, dhe mund të arrihet me ndërlidhjen e qyteteve Prishtinë-Shkup-Tetovë, deri në Tiranë dhe Durrës, kundrejt asaj që arrihet me "Koridorin 8te".

Me anë të kësaj strukture rrugore, të gjitha qendrat e fuqishme ekonomike, mund të lidhen jo vetëm në aspektin ekonomik, por bëhet ndërlidhje shumë funksionale e qendrave rekreative sportive dimërore dhe turistike siç janë: Luboten, Kodra e Diellit, Mavrovë, Bistra, Galiçnik, Liqeni në afërsi të hidrocentralit në Dibër etj. Kështu mundësohet vërja në funksion të të gjitha hoteleve dhe zhvillimit të pjesëve të tjera të pasurive natyrore, rreth kësaj autostrade, me peshë të veçantë për banorët e gjithë regjionit.

Me ndërlidhjen e këtyre qendrave, prej Shkupit deri në qendrën sportive Bistra do të mund të arrihet për një orë vozitje, kurse prej Mitrovice dhe Prishtine, për dy orë. Është me rëndësi të përmendet edhe fakti se Qeveria e Shqipërisë ka më të përgatitur programe dhe dokumentacion teknik, në të cilin punohet me intensitet të vazhdueshëm për ndërtimin e autostradës me vlerë të madhe historike të quajtur "Rruga e Arberit", i cili do të shtrihet prej Tirane gjer në Dibër. Ky variant është i mirëseardhur nëse merret parasysh ajo se, Shqipëria shumë shpejt do të fillojë me ndërtimin e rrjetit rrugor, gjegjësisht autostradës Tiranë-Dibër, me investitor koncensional.

Me ndërtimin e autostradës Gostivar-Dibër, qendrat e mëdhaja siç janë, Shkupi, Prishtina dhe Tirana me këtë rrjet rrugor, do të jenë shumë afër njëri-tjetrit të lidhur si pika evropiane, dhe atëhere, Dibra do të bëhet një Portë e Hapur e kësaj pjese të Europës Juglindore.

Ky variant propozohet edhe për shkak se rruga e tanishme e Mavrovës që lëviz përgjatë lumit Radika, nuk ka asnjë mundësi të zgjerohet, për shkak se ky lum paraqet aktravitet të veçantë dhe të rrallë natyror me florë dhe faunë të pasur, dhe kjo rrugë nuk ka gjasa të zgjerohet më shumë se 5-5.5 m.

Me ndërtimin e kësaj autostrade në tërë këtë regjion, do të mund të përfitohet mjaft, shumë më shumë për shkak se autostrada e paraparë do të bëhet me dy kahje, paralel ose përafër rrugës që ekziston momentalisht, në vijën Gistovar-Kërçovë-Strugë, e cila paraqet një absurd, kurse lëmë pas dore një autostradë (që lidh qytetet dhe fshatrat) si formë amorfe, dhe se ndërtojmë edhe një autostradë tjetër me anë të së cilës i zhdukim pasuritë e shumta me durnj, kurse nuk lidhim asnjë qendër të fuqishme ekonomike dhe qendra turistike që i kemi përmend më lart në këtë analizë-propozim.

Varianti për ndërtimin e autostradës si që është "Koridori 8te", që duhet të ndërlidhë Gostivarin, Kërçovën dhe Strugën, është investicion shumë i shtrenjtë, për shkak se duhet të ndërtohen shumë ura me gjatësi totale deri në 10 km, si dhe tunel me gjatësi prej 2 km, kurse traseja rrugore është shumë më e gjatë, në krahasim me variantin e kalimit nëpër Dibër, i cili është më i shkurtër dhe më i lirë në çdo aspekt.

Rruga ekzistuese prej fshatit Novo Sellë, që kalon përafër qytetit të Gostivarit, deri tek vendi i quajtur "Boshkovmost" deri tek kufiri shqiptar, ka vetëm 15 km, ashtu që e tërë gjatësia rrugore ka vetëm 53 km. Vetëm sa për të krahasuar, potencoj faktin e pamohuar se, rruga ekzistuese Gostivar-Qafë e Thanës prej fshatit Novo Selë ka gjatësi rrugore 110 km.

Duhet theksuar se autostrada prej Dibre për në Bulqizë dhe në Tiranë, si propozim i projektuar, do të jetë në gjatësi 75 km, kurse aksi që duhet të kalojë në Qafën e Thanës – Durrës – Tiranë është më shumë se 200 km, që nënkupton se deri në Tiranë do të kemi një autostradë më të shkurtër për 125 km. Nga kjo duhet të kuptojmë se nga aspekti ekonomik ky variant që propozohet është shumë më i kapshëm dhe i arsyeshëm.

Rruga e re e ndërtuar nga Elbasani në drejtim të Librazhdit, Prrenjasit dhe Qafë Thanës është shumë rëndë të inkorporohet në autostradë me karakter europian, për shkak se, është ndërtuar pa studim adekuat, me kthesa shumë të ashpra si dhe lëshime dhe ngritje joadekuate rrugore etj.

Rruga e re e cila përgatitet për ndërtim prej Tiranë për në Bulqizë dhe Dibër do të jetë e ndërtuar si autostradë moderne me të gjitha përformansat. Parashtrohet pyetja: çka do të ndërtohet nga ana e jonë, gjegjësisht në Maqedoni? Edhe nga ky aspekt propozohet ky variant, si më i përshtatshëm dhe më i shkurtër.

Duke e marrë për bazë se dokumentacioni teknik për ndërtimin ne autostradës "Koridori 8te", në drejtimin Gostivar-Kërçovë-Qafë e Thanës, është në fazën përfundimtare, dhe për këtë arsye propozohet të përpilohet dokumentacioni teknikprojekt, si variant i ri që ndërlidh vendet, Gostivar-Leunovë-Boshkovmost-Dibër, e pastaj të bëhet krahasimi në mes dy projekteve. Krahasimet të cilat do të analizohen nga ana e ekspertëve sigurisht do t'i konstatojnë argumentete e mia të prezantuara më lart në këtë analizë.

Perfundimisht konsideroj se është e nevojshme të theksoj edhe rrethanën, se për ndërtimin e kësaj autostrade ka shumë kompani të interesuara të cilat do të dëshirojnë të kyçen në ndërtimin e saj me koncesion, për shkak se nëpër këtë autostradë prej Mitrovicë, Prishtinë, Jazhincë, Tetovë, Gostivar, Leunovë (Mavrovë), Bistra, Boshkovmost, Dibër, Bulqizë, Tiranë dhe gjer në Detin shqiptar (porti i Durësit), do të qarkullojnë numër shumë i madh i automjeteve dhe do të jetë rrugë rentabile për ndërtime me sistemin e koncesioneve.

Për një variant të këtillë, personalisht kam dijeni se, për një tender të hapur të këtij lloji, janë të interesuar të marrin pjesë në koncesion shumë kompani nga Europa siç janë: "Strabak" – Vjenë, "Tema" – Athinë, "Enka" – Stamboll, e kompani të tjera të interesuara, sidomos italiane.

(Autori është drejtor i ndërmarrjes së përbashkët gjermano-maqedone "KIFER" me seli në Shkup)



Lugina piktoreske e lumit afër Zall Dajtit

Si e kujtoj unë "Rrugën e Arbërit"

Nga AGIM KABA,
SHBA

Shumë shkrimtarë e jo shkrimtarë, kur nisin të shkruajnë një ndodhi rëndom e fillojnë pothuaj njëlloj … "Mora penën të shkruaj këto kujtime… apo rreshta…", ndërsa unë parapëlqej ta bëj hyrjen sa më "moderne", pra "mora laptopin" për të shtypur kujtimet e mia: Si e njoha unë, e cila është në të vërtetë Rruga e Arbërit, apo siç quhej e njihej në popull, Rruga e Dibrës!

Mbaj mend se rruga që fillon në qendër të Tiranës e shkon deri në Kinostudio e më pas të çon drejt malit të Dajtit quhet sot rruga "Bajram Curri", por për vendasit shpesh ajo njihej e emërtohej me tjetër emër si rruga e Dibrës!! Pra, ishte rruga që të çonte drejt Dibrës, sikurse qe rruga me emrin rruga Elbasanit apo rrugët e Durrësit e të Kavajës. Ishte verë e vitit 1950, kur unë isha vetëm 10 vjeç e shkova për herë të parë nga Tirana në fshatin malor të Gurit të Bardhë, të rrethit të Burrelit. Kishte ditë që ishim të ftuar nga nipi i tim eti për një vizitë në atë fshat. Ndoshta unë gëzoja më shumë se çdokush tjetër, për dy arsye: e para, se do të lija monotoninë e vapën e madhe të Tiranës në korrik dhe e dyta, do të kaloja për herë të parë matanë malit të Dajtit, që ishte si një ëndërr për një fëmijë si unë. Para se ta bënim atë rrugë kisha mësuar nga im atë se ajo qe rruga që ai kishte përshkuar kur ishte fëmijë fare i vogël. Ai së bashku me familjen e tij dhe mijëra bashkëqytetarë të tjerë e lanë Dibrën e Madhe dhe u dyndën drejt tokës amë Shqipërisë për në Tiranë, të detyruar nga hordhitë serbe. Ata e bënë gjithë rrugën në këmbë për dy-tre ditë. Vite më vonë ai e kishte përsëritur atë udhëtim edhe herë të tjera. Kjo ishte rruga e Dibrës! Mezi më zuri gjumi ngaqë rashë herët. Do të udhëtonim që pa gdhirë mirë për t'ju shmangur vapës dhe të arrinim sa më parë në Gur të Bardhë. Më kishte përfshirë një gëzim i madh për këtë udhëtim të panjohur. Një zhurmë e lehtë dhe pëshpëritje vinte nga kuzhina. Ishin duke u marrë me përgatitjet, kur dëgjova që më kërkonin të ngrihesha. Prisha sakaq ëndrrat që po shihja dhe u ktheva në realitet, brofa në këmbë si për të treguar se isha gati për atë sfidë që dikush më qante hallin "... si do eci ky është kalama dhe ajo rrugë nuk është një bulevard i shtruar, por male e humnera…". Më kujtohet fare mirë se si im atë që dëshironte të shkoja me të me çdo kusht, thoshte "edhe ne kemi qenë fare të vegjël kur e kemi kaluar këtë rrugë shumë vite më parë.". Së bashku me tim atë ishin edhe dy apo tre fshatarë vendas, që ktheheshin nga dita e enjte, dita e pazarit në Tiranë, kur u nisëm për në fshatin e tyre të bukur të Gurit të Bardhë. Ai fshat ndodhej në kurriz të malit me Gropa ose më saktë në anën veri-perëndimore të tij.

Djali i dajës, Nekiu, ishte arsimtar në shkollën e vogël të fshatit Gur i Bardhë. Të ishe arsimtar në një fshat të thellë malor në ato vite ishe person i rëndësishëm, njeri i nderuar dhe i respektuar nga fshatarët vendas. Nekiu e kishte fituar respektin e tyre falë një pune mjaft të mirë e me vetëmohim në shkollë e në jetën e përditshme.

Dihet nga historia e kombit shqiptar se Guri i Bardhë ishte vendlindja e Pjetër Budit. Në vazhdë të tij, disa qindra vjet më vonë aty lindën dhe mbaruan shkollën fillore, pra morën edukimin e parë, bashkëmoshatarët e mi, nxënësit e shkëlqyer të asaj shkolle, politikani i njohur shqiptar Abdi Baleta, mjeku dhe pedagogu Tahir Hysa dhe disa vite më vonë kolegu im inxhinieri K.Kokoshi e shumë të tjerë që pata rastin në atë kohë e më vonë t'i njoh nga afër.

Unë isha me pushimet verore të shkollës fillore, ndërsa shkolla e vetme në atë fshat ishte shkollë fillore verore, pra, mbyllej në një periudhë të caktuar të dimrit, nga dëbora e madhe të ftohtit e ngricat. Në verë dita atje ishte e nxehtë, por mbasditja freskohej derisa ia linte të ftohtin natës. Kjo lloj klime ishte shumë e pëlqyeshme dhe e preferueshme sidomos për ne që vinim nga qyteti i Tiranës ku në korrik e gusht piqej veza në diell!!

Nga Tirana, më saktë nga shtëpia ime që ndodhej pranë Pazarit të Ri, u nisëm mjaft herët, rreth orës 4 të mëngjesit, në këmbë e të shoqëruar nga fshatarët gurabardhas që kishin me vete kafshë të ngarkuara me mall, pas atij pazari të një dite më parë. Në lindje të qytetit, pasi lamë Spitalin Civil zbardhi drita plotësisht dhe ne me një ecje normale ju afruam Rapit të Trishit apo kafes së Rremës siç u quajt më vonë, ku dhe u bë ndalesa e parë. Aty në të djathtë të rrugës në rrëzë të një rrapi gjigant, që kish marrë emrin vendi – rrapi i Trishit, ishte një burim me ujë të ftohtë. Pas një pushimi disa minutash u nisëm për udhë. Kur vazhduam udhëtimin për më tutje, fshatarë të tjerë u bashkuan me ne dhe u krijua një kollonë njerëzish e kafshësh, që në heshtje marshonim drejt malit të Dajtit.Vende-vende, në drejtim të kundërt, takonim grupe të ndryshme udhëtarësh, që pas një përshëndetje, largoheshin për në drejtim të Tiranës. Unë, ngaqë isha i vogël, e kalova një pjesë të rrugës hipur mbi mushkë. Pasi lamë Rrapin e Trishit kaluam në rrëzë të kodrave të Shtish Tufinës dhe më pas u ndodhëm tek Ura e Brarit.

Ky vend ishte i fiksuar në disa fotografi që kisha në shtëpinë time. Lumi i Tiranës atje kalonte nëpër disa gropa të thella në shkëmb, të krijuara nga gërryerjet e ujit të rrëmbyeshëm e që komunikonin me njëra- tjetrën nëpërmjet ujit të lumit që rridhte pareshtur në to dhe më pas kur dilte prej tyre që quheshin dhe "puset" e Brarit hapej më i qetë në një luginë të sheshtë dhe kështu rridhte duke lënë pas edhe periferinë e Tiranës dhe pasi bashkohej me lumin e Tërkuzës, paksa në veri të aeroportit ndërkombëtar "Nënë Tereza" dhe më vonë në afërsi të Fushë-Krujës bashkohej me lumin e Zezes dhe derdhej në veri të Kepit të Rodonit në detin Adriatik, por tashmë me një emër të ri si lumi i Ishmit. Në ato fotografi ishte im atë vetëm ose me shoke, duke u larë në ato "puse" ose shpesh duke pozuar i ulur në majë të gropave në shkëmb. Megjithëse kisha pyetur tim atë, por dhe të tjerë më kishin treguar sesi ai në të shumtën e kohës qëndronte në majë të shkëmbit në gatishmëri për ndonjë që rrezikohej të mbytej… Kishte plot dëshmitarë që e njihnin atë si një shpëtues të sa e sa të rinjve që nuk dinin të notonin mirë, pra një "lifeguard" si në seritë e filmit "Baywatch". Ai ishte një notar i shkëlqyer dhe dashuronte pa masë ujin. Të notuarit i sillte atij një kënaqësi të pashpjegueshme. Gjithmonë kur futej në ujem, lumë apo det ai mezi dilte që andej. Në det shpesh bëhej "pikë" siç thoshim ne për ndonjë që notonte në thellësi të mëdha, larg nga bregu i detit.

Natyrisht, si i lindur në Tiranë, pak vite më vonë edhe unë shkoja me shokë moshatarë të mi për të bërë banjo tek ato puse, por gjithmonë fshehtazi nga prindërit tanë, se kishin ndodhur edhe të mbyteshin, prandaj ne kurrë nuk lejoheshim të shkonim atje, por si çdo gjë e ndaluar që të josh më tepër edhe ne shkonim e nuk pyesnim fare. Ishte një kënaqësi të laheshe brenda në ato puse, sidomos kur me lehtësi kalonim nga një pus te tjetri pa menduar se kish ndonjë rrezik. Të gjitha këto ndodhën kur Tirana ishte akoma një qytet i vogël, se pas viteve '60 as që bëhej fjalë për të shkuar aq larg, qyteti ndryshoi shumë dhe u zmadhua së tepërmi, lumi filloi të ndotej nga papastërti të shumta që hidheshin në të dhe ne kishim argëtime nga më të ndryshmet, kështu që u harruan vajtjet aq larg në lumë, kur për 45 minuta me tren ishte Durrësi me plazhin e tij fantastik…

Udhëtimi ynë vazhdoi në rrëzë të kodrave të Linxës dhe më pas u ndodhëm në faqen veriore të malit të Dajtit, ku filluam të ngjiteshim në Shkallën e Tujanit.

E famshmja Shkallë e Tujanit ishte një gjurmë e lashtë rruge këmbësorësh nëpër shkëmbinj të varur teposhtë kërcënueshëm, vende-vende shumë e ngushtë ku kafshët i mbanin e tërhiqnin pas kapistallit. Kishte pjesë në ca vende që kafshët i shtynin nga mbrapa për të kapërcyer e ngjitur në ca shkëmbinj si prag. Rrallëherë, por edhe kish qëlluar që ndonjë kafshë të rrëzohej dhe të bëhej çika-çika atje poshtë në shkëmbinj të çarë nga uji i lumit të Tiranës.

Pamja aty ishte sa madhështore, aq edhe e frikshme për një fëmijë të vogël si unë. Lumi i Tiranës, që i kish burimet në rrëzë të malit me Gropa kishte çarë si me shpatë malin e Dajtit dhe malin e Priskës së Vogël, për të vijuar udhëtimin e vet përgjatë luginës. Thellë poshtë në atë grykë të ngushtë dallohej lumi me ujë të pastër, që rridhte drejt Tiranës.

Në të zbritur të Shkallës së Tujanit, pas afro një ore udhëtimi u hap një pamje tjetër madhështore, një luginë e thellë, që gjarpëronte degëve të përrenjve të shumte, të cilët së bashku formonin lumin e Tiranës.

Vite më vonë u hap rruga automobilistike që lidhte Zall Dajtin e Zall Bastarin me Tiranën dhe unze, tashmë një inxhinier bëra disa matje për rezervat shtetërore tamam në rrëzë të Shkallës së Tujanit, që kisha kaluar në fëmininë time. Aty pashë nga afër ujin e lumit që herë-herë zhdukej në të çarat e shkëmbinjve kanione gëlqerorë dhe dilte më poshtë, duke rrjedhur me vrull drejt Tiranës. Nga poshtë, ngriheshin në të dy anët shpate të thepisura shkëmbore të dy maleve fqinje, atij të Dajtit e të Priskës së Vogël, me drunj të thatë dhe zallishte që sipër tyre lejonin të dukej vetëm një pëllëmbë qiell. Fare mirë dallohej gjurma e rrugës këmbësore të Shkallës së Tujanit që ishte aq e famshme për kohën e vet, por që pothuaj nuk përdorej më, sepse tanimë ishte hapur traseja e plotë poshtë në buze të lumit…

Në Zall Dajt, pas një pushimi kaluam dy-tre herë lumin dhe u ngjitëm pa pushim në fillim në kodrina të larta e më pas në mal. Na u desh të kalonim nëpër pyje e zona me shkurre të larta, që ndërpriteshin shumë herë nga livadhe të bukura të rrethuara me lajthi e drurë të lartë. Më vone, pasi kaluam Qafën e Murrizit, në pasditen e vonë hymë në fshatin e Gurit të Bardhë.

Përshtypja e parë, që të bënte të habiteshe ishte rruga me kalldrëm e shtruar në mes të fshatit, si dhe uji i ftohtë dhe i kulluar i një përroi plot ujë, që kalonte përmes tij. Në të dy anët e ujit që varej tatëpjetë me vrull të madh ishin shtëpitë e gurabardhesve, me pragjet e dyerve tamam tek buza e ujit. Atë vit dhe dy vite të tjera në vazhdim isha mysafir tek Nekiu, i cili banonte pranë familjes Laci.

Nga ana e fshatit, me pamje më në lindje me vështirësi dallohej poshtë Gurit të Bardhë fshati lokalitet i Klosit, më tutje Bulqiza dhe paksa përtej kufirit shtetëror Dibra e Madhe. Në perëndim të fshatit, poshtë një lugine të thellë ishte fshati fqinj i Xibrit me shkollën në shpatin e zhveshur veri-perëndimor. Në atë shkollë shkova për vizitë në vitin tjetër në vazhdim.

Ishte një kënaqësi e veçantë kur vite më vonë vëllai im Faruku, më foli plot entuziazëm për një studim në perspektivë të kësaj rruge, që paraqiste mjaft leverdi e shkurtonte e afronte ndjeshëm Dibrën me Tiranën e Durrësin. Gëzimi ishte i dyfishtë edhe për faktin se gjithmonë e kemi ndjerë veten dibranë (origjina jonë dhe e prindërve tanë të nderuar), megjithëse lindëm e u rritëm në Tiranë. Zakonet edhe gjuhen në familje i kishim dibrane dhe krenoheshim me historinë e lashtë e të re të këtij qyteti. Unë e kam parë Dibrën vetëm në harta, në fotografi interneti dhe së fundi në pamje të mahnitshme satelitore.

Ti shërbesh vendit tënd është vetëm minimumi që gjithkush ka për detyrë në këtë jetë!!

“Tre Dibrat”

Dibranët po sfidojnë kohën



Nga Rexhep TORTE

(Vijon nga faqja 1)

Ata kanë djegur shtëpitë dibrane së bashku me fëmijët dhe pleqtë brenda, kanë vrarë njerëzit e pafajshëm në oborrin e shtëpisë, të plagosurit që kanë treguar shenja jete janë shpuar me bajoneta gjer në vdekje, kanë përdhunuar, kanë grabitur tërë pasurinë dhe gjënë e gjallë, për të mos lënë asnjë kusht për vazhdimin e jetës.

Gjatë vendosjes së kufirit në Krahinën e Dibrës nuk u zbatua as konfiguracioni natyror dhe as vullneti politik i dibranëve. Shkrimtarja amerikane Rous Uajder Lein në vitet ‘20-tw të shekullit 20-të, në librin e saj “Majat e Shalës”, shkruan se “Qyteti i Dibrës iu muar Shqipërisë me vijën kufitare të vitit 1913, siç nxirret sythi i një patateje”. Ndërkaq, Dimitrije Tucoviq në librin “Serbia dhe Shqipëria”, duke përshkruar gjendjen e krijuar në viset e aneksuara nga Serbia, thotë se “aneksimi ndau bujkun prej arës, bagëtinë prej kullotës, tufën prej lugjeve, fshatin prej mullirit, blerësin dhe shitësin nga tregu, rrethin prej qytetit dhe tërë viset malore prej qendrës së tyre ekonomike e hambarët e ushqimit… burimet e jetës u prenë”.

Kufiri që vendosën serbët duke e ndarë Dibrën në dy pjesë, është kobi më i madh që ka rënë mbi Dibrën e Madhe dhe që vazhdon edhe sot e kësaj dite.

LUFTA E DYTË BOTËRORE NUK E NDRYSHOI GJENDJEN

Përfundimi i Luftës së Dytë Botërore për Dibrën e Madhe dhe dibranët qe një zhgënjim i madh dhe i pafalshëm i radhës. Përkundër pjesëmarrjes aktive të dibranëve në luftën kundër nazifashizmit, ajo sërish mbeti nën kthetrat serbosllave dhe jugosllave.

Platforma komuniste dhe moniste për kultivimin e “bashkim vllaznimit”, ku shqiptarët u nënshtroheshin rregullave maqedonase, ku parësore ishin flamuri dhe gjuha maqedonase, u zbatua strikt edhe në Dibër të Madhe. Secili që shprehte një mendim apo pikpamje më ndryshe survejohej, burgosej, persekutohej, por edhe vritej.

Pas Luftës së Dytë Botërore bijtë më të mirë dibranë u bënë pre e përndjekjeve, burgosjeve dhe vrasjeve më mizore të UDB-së serbomaqedonase. Atdhetari i shquar Cen Elezi, kundërshtar i flaktë i coptimit të trojeve shqiptare, mashtohet tinëzisht nga UDB-ja serbomaqedonase dhe pas torturave çnjerëzore vdes më 9 maj 1949 në burgun famëkeq të Kalasë së Shkupit, duke shkruar me gjak fjalët “Tradhëtia ndaj atdheut nuk falet edhe sikur të bësh shumë të mira pas saj”. Nexhat Agolli, jurist i diplomuar në Romë, me gradën zv/komandant batalioni në LNÇ, pas çlirimit emërohet zv/kryeministër dhe ministër i Asistencës sociale në Qeverinë e parë të Maqedonisë. Insistimi i tij për hapjen e shkollave shqipe bën që UDB-ja ta burgosë dhe e vret me tortura barbare më 29 prill 1949 në burgun e Shutkës në Shkup. Komplotet dhe intrigat e fëlliqura komuniste vazhduan edhe ndaj një morie intelektualësh tjerë dibranë. Në të gjitha burgjet e Maqedonisë e deri në Goli Otok gjendeshin dibranë.

NË DIBËR TË MADHE SHTETI KA INVESTUAR PAK

Investimet për zhvillimin ekonomik të Dibrës së Madhe gjithashtu ishin më të pakta se në vendet e tjera. Këtë e dëshmon edhe sot e kësaj dite rruga vetëm 5 metra e gjërë nga Dibra e Madhe për në Shkup dhe nga Dibra e Madhe për në Strugë në gjatësi prej 25 kilometrash, për të vazhduar pastaj normalisht me gjerësi prej 6 metrash.

Ndarjet territoriale pas Luftës së Dytë Botërore kishin për qëllim tkurrjen e sipërfaqes territoriale të Dibrës së Madhe, kështu që kufijtë e Dibrës së Madhe që shtriheshin gjer në Mavrovë, sa vjen po zvogëlohen.

Mosinteresimi i shtetit ka bërë që të shkatërrohen e shuhen edhe shumë monumente me vlera të rralla kulturore e historike të Dibrës së Madhe.

Themelimi vite më parë i Komunës së Rostushës dhe i Komunës Qendra e Zhupës, sipas ndarjes më të re territoriale, kanë bërë që Dibra të mbetet me sipërfaqe prej 180 mijë kilometra katrorë dhe afër 19 mijë banorë.

Vendkalimi kufitar i Bllatës, pas gjysëm shekulli ndërprerje, filloi të funksionojë me ardhjen e demokracisë në vitin 1992, për kalimin e njerëzve dhe të mallrave. Shqipëria dhe Maqedonia, të nxitur nga faktorët ndërkombëtarë, intensifikuan vizitat e ndërsjella shtetërore dhe nënshkruan më shumë se 20 marrëveshje dhe protokole, midis tyre edhe marrëveshjet e regjimit kufitar.

Megjithatë, edhe gjatë këtyre viteve të demokracisë, vendkalimi kufitar i Bllatës ende nuk është vënë në efiçencë të plotë.

Për arsye të pakuptimta transportuesit e mallrave orientohen të kalojnë dhe bëjnë çdoganimin e mallrave në venkalimin kufitar Qafë Thanë te Struga, duke anashkaluar vendkalimin kufitar të Bllatës.

Të gjitha këto i sjellin dëme të mëdha ekonomisë së zonës së Dibrës në dy anët e kufirit.

MËRGIMI, SI RRUGË SHPËTIMI

Kjo situatë e vështirë ekonomike e politike bëri që mijëra dibranë të kapin rrugën e mërgimit për kafshatën e gojës. Sot dibranë ka kudo nëpër botë, por më së shumti në SHBA. Atje janë përqëndruar afër 15 mijë dibranë. Rruga e mërgimit vazhdon edhe sot e kësaj dite, ku të rinjtë dibranë ëndrën për të shkuar në SHBA e arrijnë nëpërmjet lotarisë amerikane, por edhe duke paguar nga 25 mijë dollarë për person për kalim ilegal.

Përkundër mallit dhe dëshirës për në vendlindje, këta dibranë ardhmërinë e shohin në SHBA. Ata mundohen maksimalisht që te fëmijët e tyre t’i ruajnë gjuhën e zakonet dibrane dhe nuk kursejnë që gjatë pushimeve verore të vijnë së bashku në Dibër të Madhe. Megjithatë, rreziku i asimilimit në SHBA është i pashmangshëm.

Dibranët janë punëtorë të vyer. Ata kanë një rini të mrekullueshme, por mungesa e kushteve për zhvillim të mirwfilltë të bujqësisë, industrisë dhe turizmit ka shkaktuar papunësi të madhe dhe humbje shprese te të rinjtë.

Mërgimtarët janë ata që mbajnë gjallë shumë familje dibrane, duke i ndihmuar financiarisht. Po të mos ishin mërgimtarët, dibranët do të vuanin edhe për bukën e gojës.

Pasiguria dhe korrupsioni në Maqedoni kanë ndikuar që dibrano-amerikanët, përveç ndonjë rasti të veçantë, të mos investojnë sa duhet për mëkëmbjen ekonomike të vendlindjes së tyre.

Zvogëlimi i papunësisë dhe zhvillimi ekonomik i Dibrës së Madhe nuk mund të paramendohet pa investime nga jashtë e sidomos investime të vetë dibranëve mërgimtarë. Ndaj, duhen krijuar të gjitha kushtet e nevojshme për zhvillimin dhe shpëtimin e Dibrës së Madhe.

(Autori është gazetar i të përditshmes “Fakti” që botohet në Shkup)

“Mirënjohje SHBA për rolin e tij historik për popullin shqiptar”

Deklaratë e Keshillit Komunal të Komunes së Dibrës në lidhje me ngjarjen e fundit që ndodhi në SHBA, ku tre persona me prejardhje dibrane akuzohen për terrorizëm.

Permes Exelences se saj Znj.Xhilian Milovanoviq Ambasadore e SHBA-ve ne Maqedoni

E nderuara Exselence,

Popull mik amerikan, Keshilli i Komunes se Dibres, Republika e Maqedonise, sot me 10 maj 2007 ne seancen e jashtezakonshme, ne prani te te gjithe keshilltareve te zgjedhur nga populli i Dibres, i indinjuar dhe i shokuar nga lajmi per pjesemarrje te tre qytetareve me origjine dibrane ne grupin terorist te zbuluar ne SHBA, unanimisht mbeshtetet SHBA-ne dhe popullin amerikan ne luften kunder terorizmit dhe te gjithe formave te tij kudo qe ai paraqitet.

Dibra historikisht njihet si qytet me tolerance maksimale nderfetare dhe per bashkejetese nderetnike shembullore, nuk ka pasur dhe nuk ka ne traditen e saj rast te ketille dhe fatkeqsisht keta qytetare me origjine dibrane te larguar nga Dibra ne moshen e femijerise se hershme, nuk mund te themi se jane rritur dhe edukuar ne frymen dibrane, por jane indoktrinuar ne ndonje rreth te izoluar ku kane jetuar dhe vepruar.

Populata dibrane si dhe shqiptaret si shumice ne kete Komune u eshte mirenjohese SHBA-ve dhe popullit amerikan per rolin e tij historik per popullin shqiptar, si dhe per ndihmesen e dhe ne shtetit te Maqedonise qe nga themelimi i tij.

Qyteti i Dibres eshte qyteti proamerikan ne Ballkan per shkak se ne SHBA jeton dhe punon pothuajse nje Diber tjeter, ku dibranet jane deshmuar si qytetare lojal te SHBA-ve dhe frymen pro SHBA-ve gjithmone e kane kultivuar te gjeneratat e rinise dibrane.

Ne seancen e sotme te Keshilli i Komunes ne emer te popullates dibrane e cila ndihet thellesish te fyer mbeshteten fuqimisht drejtesine amerikane per dhenien e denimit te merituar te gjithe atyre qe merren me veprime teroriste.

KESHILLI I KOMUNES: **NIZAMEDIN PAPRANIKU**
KRYETARI I KOMUNES: **ARGETIM FIDA**

STARTON REALIZIMI KONKRET I PROJEKTEVE

DIBRANËT PRESIN VETË SHPRESËDHËNËSE

Në komunën e Dibrës, përveç projekteve infrastrukturore, mbase janë paraparë edhe projektet për realizimin e aktiviteteve kulturore, sidomos gjatë stinës së verës. Ndër manifestimet respektive, gjithësesi është mbajtjae muajit të kulturës "Dibra 2007" i cili sivjet do të realizohet nga 15 korriku deri me 15 gusht Atë që parashihnim në fillim të vitit, pushteti vendor i Dibrës me administratën e vet në fazën e përgaditjes së projekteve nga sfera e infrastrukturës, për zhvillim ekonomik lokal si dhe projektet për kulturë e sport sipas fjalëve të shefit të kabinetit Ylli Mirzo, janë duke gjetur vend në jetën e përditshme dibrane. Në këtë drejtim, në fushën e infrastrukturës vëren Mirzo, mund të thuhet se në këtë pjesë të vitit kanë arritur të realizojnë një sërë objektivash të parapara me projektet e miratuara sic është rregullimi i trotuareve në qytet, gjithashtu është kryer asfaltimi i rrugëve që kishin ngelur të pa asfaltuara në Lagjen "Venec II" poashtu u bë asfaltimi i rrugës "1 Maj" si dhe në të gjitha rajonet tjera të Dibrës. Atë që Mirzo e spikat si vepër madhore infrastrukturore ishte asfaltimi i rrugëve në lagjen "Qernanicë". Kur flasim për projektet duhet nënvizuar edhe bashkëpunimin që pushteti vendor mban me USAID-in në lidhje me zhvillimin ekonomik lokal, me c`rast kjo e fundit na ka dhënë për ndihmesë dy konsultantë, të cilët e përgadisin projektin bashkë me grupin e formuar nga pushteti vendor, ku pikë kryesore për studim dhe efektuim të projektit kanë marrë ish-kazermën ushtarake "Liman Kaba" e cila tashmë është shpallur zonë ekonomike e që ofron perspektivë për zhvillimin ekonomik të Dibrës, thotë Mirzo. Ai përkujton se të gjitha këto projekte morën bekimin e Këshillit komunal si prioritete, ndërsa tashmë ka ngelur realizimi i tërësishëm i tyre në praktikë. Mirëpo, në Komunën e Dibrës mbase janë paraparë edhe projektet për realizimin e aktiviteteve kulturore, sidomos gjatë stinës së verës. Ndër manifestimet respektive, gjithësesi është mbajtja e muajit të kulturës "Dibra 2007", i cili sivjet do të realizohet nga 15 korriku deri më 15 gusht me c`rast duhet të mbahen aktivitete nga sfera e kulturës të përcjellura edhe me aktivitete sportive. Gjatë kësaj periudhe është paraparë edhe realizimi treditor i Edicionit të VI-të tashmë tradicional "portiku poetik", është paraparë edhe shënimi i "Ditës së shalqirit" si dhe aktivitete tjera që kanë të bëjnë me kulturën nëpër shkollat e qytetit. N.S.

(www.dibra.org)



Rrugë e re në Dibër, e cila do lehtësojë shumë qarkullimin e makinave në qendër. Foto: Kushtrim U. (www.Dibra.org)

Urim për I-vjetorin e gazetës

Gazeta "Rruga e Arbërit", më e reja në shtypin shqiptar, mbush 1 vjetorin e saj. Unë i kam ndjekur me vëmendje të gjitha numrat e gazetës dhe që në fillim kam ndjerë një krenari të veçantë për këtë rrugë të nisur, për larminë e madhe të problemeve që trajtohen për trevën e Dibrës nga kjo gazetë, trevë e cila ka lënë gjurmë të pashlyeshme në historinë e popullit shqiptar.

Si intelektual i Bulqizës, në këtë përvjetor shpreh konsideratën më të lartë për stafin drejtues të gazetës, për personat që kanë mbajtur dhe e mbajnë gjallë atë dhe ju uroj gjithë të mirat e suksese të mëtejshme.

Për të gjitha problemet që trajtohen me mjaft nivel shkencor e teknik, me një paraqitje të mrekullueshme tipografike që konkurron me sukses shtypin e sotëm, gazeta "Rruga e Arbërit" ka dhe do të ketë vlera të pallogaritshme për trevën e Dibrës.

Nuk ka gjë më të bukur dhe të vyer që të bësh diçka për vendin tënd. Edhe njëherë suksese dhe punë të mbarë në rrugën e nisur!

Sefedin Shabani,
inxhinier gjeolog në Bulqizë

Në zërin e referuesve dhe të drejtuesve të Kuvendit sot në Tiranë është e gjithë Dibra

Dibra e kuvendeve të luftës dhe penës.

Dibra e trimave dhe e punës.

Me 26 maj 2007 elita përfaqësuese e gjithë Dibrës mbledh Kuvendin Tekniko-Shkencor për rrugën e Arbërit.

- Me 11 nëntor 1443 në Dibër u mblodh Kuvendi i Skënderbeut, i cili përcaktoi planet luftarake për shpëtimin e Kombit.
- Me 20 tetor 1888 u mblodh Kuvendi i Jashtëzakonshëm në mbështetje të Lidhjes së Prizrenit me 300 delegatë e 5000 forca të armatosura.
- Me 28 shkurt deri me 16 mars 1899 u mblodh Kuvendi për bashkimin e Lidhjes Shqiptare të Pejës.
- Me 23 korrik 1909 u mblodh Kongresi mbarëkombëtar për çështjen ekonomike e kombëtare.

Kuvendet e Dibrës janë udhëhequr nga Ymer Prizreni, Iljaz Pashë Dibra, Seit Najdeni, Elez Isufi, Josif Bogeri, Haxhi Agolli, Isuf Xhelili, Dom Nikollë Kaçorri, Haki Stërmilli e shumë e shumë të tjerë.

Sot në këtë Kuvend prin inteligjenca, elita pasardhëse e Korifenjve të Dibrës.

Urojmë që nga ky Kuvend, që për nga rëndësia është i jashtëzakonshëm, të dalin me vendime dhe zëri i tij dhe i gjithë trevës dibrane në të dy anët e kufijve të merret në konsideratë nga qeveria shqiptare, duke korrigjuar gabimet historike ndaj kësaj treve e lënë në harresë.

Në zërin e referuesve dhe të drejtuesve të Kuvendit sot në Tiranë është e gjithë Dibra.

Punë të mbarë!
Isuf Miho

BËNI ABONIMIN TUAJ

Në mënyrë që gazeta "Rruga e Arbërit" të jetë sa më pranë lexuesit, redaksia njofton se vazhdojnë abonimet.

Abonimi për periudhën **Maj - Dhjetor 2007** kushton **400 lekë,** ndërsa për periudhën **Qershor - Dhjetor 2007** kushton **350 lekë.**

Abonimet në Tiranë mund t'i bëni pranë redaksisë së gazetës në numrat: **Cel: 068 31 19 232** ose në numrat fiks **(04) 357 179; 233 283.**

Abonimet në Peshkopi mund t'i bëni pranë librarisë **"Fleta XXI"**, pranë Gjimnazit "Said Najdeni", me nr. **tel: 0218 4233.**

Të interesuarit për abonime duhet të lënë patjetër emrin e saktë dhe adresën ku presin t'ju shkojë gazeta.

Duke bërë abonimin tuaj, ju bëheni pjesë e gazetës!

Ju kujtojmë se nga numri 13-të e në vazhdim, çmimi i gazetës do të jetë 50 lekë. Bashkëpunimet për gazetën priten deri më datë 20 të cdo muaji.

PESHKOPISË

Porsi gur i xhevahirit
Rrëzë mali, buzë përroi,
Peshkopi, qytet i dashur
Kush të pa dhe të harroi?

Në Gropë teqja dhe xhamia
Seç po rrinë përkarshi,
Në pllajë vila dhe pallate
Lagje re, qytet i ri.

Rrugë të drejta dhe të pastra,
Uj' i akullt, klimë e mirë,
Mbi të gjitha bukuritë
Bulevardi nën blirë.

Dhe dibranët punëtorë,
Sa bujarë dhe sa të zgjuar,
Dritë e jetë ty të japin
Peshkopi vend i bekuar.

Myrteza Baboçi

Prof.Dr. Nuri Abdiu boton "Psikologjia e Hasan Tahsinit"

Një vepër dinjitoze për historinë e mendimit psikologjik

Prof.Dr. **VEHBI HOTI**

Prej vitesh kemi pasur rastin të nji hemi dhe të ndjekim punimet e Prof.Dr. Nuri Abdiut në fushën e historisë së mendimit psikologjik shqiptar. Ai është nismëtari i studimit të kësaj fushe në vendin tonë, më i angazhuari e më i përkushtuari , nga studiuesit shqiptarë për problemet e historisë së mendimit psikologjik.

Me një punë intensive e pasionante prej rreth katër dekadash ai ka çarë një rrugë të parrahur më parë nga studiues të tjerë, ka hedhur dritë mbi një traditë të hershme të mendësisë e të mendimit psikologjik shqiptar si pjesë përbërëse dhe e pandarë e kulturës dhe e jetës shpirtërore të popullit tonë, si tregues i vitalitetit i individualitetit të tij. Kjo ka qënë një ndërmarrje e madhe dhe e vështirë nga autori sepse ato janë realizuar në kushtet e një mungese pothuajse të plotë të studimeve të kësaj fushe, i është dashur të zgjedhë mjaft probleme si ato të gjetjes e të evidentimit të punimeve shqiptare të mirëfillta psikologjike ose me karakter psikologjik, të periodizimit të zhvillimit të këtij mendimi psikologjik, të terminologjisë së përdorur e interpretimeve përkatës, të ballafaqimeve me mendimin psikologjik bashkëkohor botëror, etj.

Si studiues e kërkues këmbëngulës, Prof. Dr. Nuri Abdiu, porsi një bletë punëtore, ka arritur të mbledhë, të klasifikojë e të periodizojë, të studiojë e të sistemojë tërë trashëgiminë kombëtare në fushën e mendimit psikologjik, të publikuar në mbi 150 zëra me artikuj, referate, botime e kumtime brenda e jashtë vendit, duke filluar që nga viti 1969 me "Një vështrim historik mbi punimet shqiptare në fushën e psikologjisë", e duke ardhur tek monografia "Kontribute themelore në historinë e mendimit psikologjik shqiptarë (gjer më 1939)", botuar pak kohë më parë.

Tani ai po na prezantohet me një monografi tjetër "Psikologjia ose Dituri mbi shpirtin" të Hasan Tahsinit. Është një vepër e gatuar ndër vite, është rrjedhim i një pune shumëvjeçare, i formimit të gjerë psikologjik dhe i kulturës profesionale të tij, i dashurisë së thellë dhe i respektit të veçantë për atdhetarin e dijetarin e madh të Rilindjes sonë Kombëtare.

Monografia përfaqëson studimin e parë serioz, të thelluar e tërësor të "Psikologjisë" të Hasan Tahsinit dhe përbën një ndihmesë të çmuar vetjake të autorit në studimet tona historiko-psikologjike. Ajo mbart vlera të shumanshme, ndër të cilat po veçojmë disa prej tyre:

Së pari, "Psikologjia" e Hasan Tahsinit, ndonëse një vepër me përmasa të vogla, ajo përmban vlera të mëdha, të cilat, i ka trajtuar e paraqitur me mjaft mjeshtëri e kompetencë shkencore autori gjatë tërë monografisë. Për këto vlera të mëdha të saj mjafton të theksojmë argumentet e autorit se "Psikologjia" e H.Tahsinit është dokumenti dhe burimi i parë i mirëfillte dhe autentik psikologjik me të cilin zë fill psikologjia dhe historia, jo vetëm e psikologjisë shqiptare por edhe psikologjia e historia e psikologjisë në Perandorinë Osmane në gjysmën e dytë të shek. XIX.

Autori argumenton drejt e qartë se "Psikologjia" e H.Tahsinit megjithëse është shkruar në gjuhë të huaj, ajo përfaqëson një kontribut të shquar në historinë e psikologjisë shqiptare. Në monografi theksohet se mendimi psikologjik shqiptar i kultivuar që në hapat e para të tij, ka ecur me kohën, ka ndjekur e përqafuar arritjet më bashkëkohore europiane. Aq më tepër e ka realizuar një gjë të tillë H.Tahsini i cili e njohu nga afër jetën, kulturën e shkencën perëndimore në një nga qendrat më përfaqësuese të saj, në Paris të Francës. Qoftë edhe vetëm për evidentimin dhe argumentimin e këtyre fakteve, monografia është e mirëpritur dhe shënon një kontribut të shquar për shkencën e psikologjisë shqiptare, për kulturën tonë kombëtare dhe më gjerë.

Për të arritur në hartimin e kësaj monografie ka ndikuar së tepërmi përvoja e gjatë e autorit si pedagog i lëndës së psikologjisë në disa universitete si në atë të Shkodrës, të Tiranës, të Tetovës, e së fundi edhe në një universitet jo publik, njohja e thellë e problemeve teorike të shkencës së psikologjisë dhe të historisë së saj, si në rrafshin kombëtar, ashtu dhe në atë botëror, kultura e gjerë psikologjike e shkencore që ai zotëron.

Së dyti, autori na ka dhënë përmasat e shquara e tepër të spikatura atdhetare e shkencore të personalitetit të H.Tahsinit. Në një sintezë elokuente na paraqitet H.Tahsini si një pjesëmarrës aktiv në lëvizjen çlirimtare shqiptare të kohës, nismëtar i krijimit të shoqatave atdhetare për mbrojtjen e të drejtave kombëtare të shqiptarëve, përpjekjet e tij për zhvillimin e gjuhës shqipe, ngritjen e përhapjen e arsimit, si një nga hartuesit e Alfabetit të Stambollit. Njëherit, H.Tahsini na paraqitet si një dijetar i madh, erudit me interesa të gjëra shkencore, filozof, gjuhëtar, psikolog, krijues letrar, njeriu që e thoshte me kompetencë fjalën e vet në shumë fusha të shkencave natyrore, që kishte përvetësuar, jo vetëm kulturën e lindjes e filozofinë arabe por edhe kulturën europiane. Siç na informon autori, njohësit e studiuesit e kanë veçuar H.Tahsinin si një dijetar "më i lartë ndër të lartit" si "më i zoti filozof dhe dijetar i shek XIX", si një nga "mjeshtërit më të shquar të penës në fushën e poezisë", në Perandorinë Osmane, si "Lomonosovi i Turqisë", etj.

Por, veçoritë më thelbësore të personalitetit shkencor të H.Tahsini na i ka lënë të skalitura nxënësi i tij një figurë tjetër madhore atdhetare e shkencore e Rilindjes sonë, Sami Frashëri, kur në veprën e tij 'Enciklopedia" theksohet se H.Tahsini "Është një nga dijetarët e kohëve të fundit që njihte mirë shkencat pozitive dhe tradicionale si dhe shkencat e reja në gjuhët e lindjes e të perëndimit" edhe se "Jetën e tij e kaloi midis librave të shumtë dhe instrumenteve shkencorë, duke studiuar dhe duke dhënë mësim. Nuk u martua dhe nuk u mor me asgjë tjetër në botë përveç shkencës"

Me cilësitë e larta shkencore e njerëzore, H.Tahsini u afirmua si një figurë madhore e kulturës e shkencës shqiptare dhe njëherit si një nga përfaqësuesit më të shquar të shkencës turke dhe të arsimit të lartë të Perandorisë në shek. XIX, duke qenë edhe Rektori i parë i Universitetit të parë të Stambollit.

Së treti, Hasan Tahsini në veprën e vet ka trajtuar problemet më themelore të shkencës së psikologjisë në përgjithësi dhe, të shkencës së psikologjisë së përgjithshme, në veçanti. Këto probleme, autori i monografisë i ka organizuar, sistemuar e klasifikuar në disa drejtime, siç janë ato mbi objektin e psikologjisë e raportet e saj me filozofinë e logjikën, kuptimin mbi bazat materiale fiziologjike të psikikës të lidhura ngushtë me funksionet e sistemit nervor e të organeve të shqisave, kuptimin mbi njeriun dhe ndryshim e tij nga kafsha, trajtimin e disa proceseve psikike, problemet mbi gjuhën, si një nga dukuritë shoqërore dhe raportet e saj me të folurit e të menduarit.

Në monografi argumentohet, drejt e saktë, fakti se H.Tahsini i ka trajtuar problemet themelore të psikologjisë përgjithësisht mbi baza natyrore e materialiste, se ai ka meritën e padiskutueshme se i dha psikologjisë që në fillimet e saj një orientim të qartë shkencor duke u mbështetur në të dhënat më të fundit të shkencave biologjike, anatomisë e të fiziologjisë së sistemit nervor.

Një gjë e tillë nuk ishte e lehtë për H.Tahsinin ai gjendej përballë pushtetit teokratik të Perandorisë Osmane, përballë ideologjisë e botëkuptimit fetar që i jepnin tonin gjithë jetës shtetërore, arsimore e shoqërore. Në një masë të caktuar, në një farë mënyre, ai ishte, si të thuash, edhe përballë vetvetes, sepse nuk është plotësisht i liruar nga ndikimet fetare, aq më tepër po të kemi parasysh edhe faktin se për disa kohë e, në periudha të caktuara, H.Tahsini ushtroi edhe detyrën e hoxhës apo të imamit të xhamisë.

Në këto kushte të propagandoje dije të sakta mbi njeriun, ndërtimin e trupit të tij dhe prejardhjen shtazore nga "majmunët që u ngjajnë njerëzve", mbi raportin e shpirtit me sistemin nervor dhe psikikën si funksione të trurit, mbi rolin e mekanizmave nervore në lidhjen e trupit me botën e jashtme dhe rolin e shqisave në pasqyrimin e njohjen e botës, mbi aftësitë e jashtëzakonshme të njeriut, për të menduar e arsyetuar, për t'u bërë "zot mbi kafshët dhe për të vendosur pushtetin mbi natyrën", ta trajtosh gjuhën si një dukuri shoqërore dhe si një mjet komunikimi në mes njerëzve "për të shprehur atë që njeriu ka në mëndje e në zemër", etj; përbënte një akt të madh shkencor.

Jo vetëm kaq. Të jesh hartues i një vepre që i bie ndesh filozofisë e botëkuptimit sundues të një perandorie të tërë, ishte edhe një akt tepër i guximshëm, vetëmohues, civilizues e revolucionarizues i mendimit shkencor në përgjithësi dhe i shkencës së psikologjisë, në veçanti. Dhe një të tillë e ka arritur në shkallën më të mirë të mundshme për kohën dijetari ynë Hasan Tahsini apo siç njihet gjerësisht me emrin Hoxhë Tahsini.

Në mënyrë mjeshtërore, Prof.Dr Nuri Abdiu ka arritur t'i nxjerrë e t'i argumentojë këto arritje e vlera të "Psikologjisë" së H.Tahsinit.

Së katërti, monografia dallohet për kulturën shkencore e kulturën gjuhësore me të cilën është shkruar. Autori ka arritur të na japë një botim të nivelit akademik në kuptimin e plotë të fjalës. Jo vetëm për kriteret mbi të cilat është hartuar, por edhe për faktin se jepet për herë të parë në mënyrë të plotë vepra "Psikologji" e H.Tahsinit në përkthimin e orientalistit të mirënjohur Vehxhi Buharaja, e shoqëruar me origjinalin e botimit në osmanisht.

Së pesti, monografia transmeton, (mbart) vlera të mëdha edukative që lid- ▶



Hasan Tahsini

Prof. Dr. Nuri Abdiu, me monografinë që paraqet i bën një shërbim të rëndësishëm një rrethi të gjerë lexuesish e studiuesish, jo vetëm të fushës së psikologjisë por edhe të filozofisë, të sociologjisë, të gjuhësisë e të kulturës së popullit tonë, përgatitjes profesionale e ngritjes së kulturës psikologjike të mësuesve tanë.

▶ hen me argumentimin e traditave shkencore e kulturore shqiptare, me kontributet e shquara shkencore që kanë dhënë dijetarët shqiptarë apo me origjinë shqiptare edhe në fusha kaq të vështira e pak të lëvruara edhe në vendet europiane të shek XIX, siç është ajo e psikologjisë, se studiuesit tanë janë bërë edhe nismëtarë të studimeve e lëvrimeve shkencore edhe për vendet e tjera. Këtë bëri H.Tahsini me veprën "Psikologjia" në Perandorinë Osmane. Po këtë gjë, në të njëjtën kohë me të bëri në Itali, shkencëtari me origjinë shqiptare, arbëreshi Gabriel Bukola, mjek e psikiatër me famë botërore, i cili konsiderohet si themeluesi i psikologjisë eksperimentale në Itali. Kontributet psikologjike të G. Bukolës e plotësojnë dhe e bëjnë me interes të veçantë monografinë dhe i bëjnë më të spikatura vlerat e saj.

Nuk ka se si të mos jesh krenar për faktin se studiuesit shqiptarë kanë qenë tepër të ndjeshëm ndaj arritjeve më të mira shkencore botërore, i kanë përvetësuar ato në mënyrë aktive e krijuese, i kanë transmetuar ato në dobi të shkencës e të kulturës njerëzore, qoftë asaj shqiptare, qoftë asaj të vendeve ku kanë jetuar e punuar. Dhe si shembulli më i mirë në këtë drejtim na paraqitet H.Tahsini. Vepra e tij është shprehje e qartë e rrezatimit kulturor, shkencor e intelektual të dijetarëve të shquar shqiptarë në kulturat e vëndeve të tjera.

Së gjashti, autori i monografisë është tepër i entuziazmuar nga vepra e H.Tahsinit dhe si të thuash i dashuruar pas saj. Ajo sikur e ka përpirë të tërin. Nuk kishte si të mos ishte i tillë, duke marrë parasysh kohën kur u shkrua "Psikologjia" e H.Tahsinit, vendin ku u botua, rrugën që hapi në një shkencë të panjohur në Perandorinë Osmane dhe në Shqipëri, si dhe për problemet që trajton dhe nivelin e interpretimit të tyre. Me gjithë këtë ai është shumë i matur, tregohet rigoroz, përpiqet të jetë sa më objektiv, ta vërë veprën e H.Tahsinit në kohën e vet, në vendin e në nivelin e vet, me arritjet më të mira shkencore, por edhe me ndonjë kufizim, pasaktësi apo njëanshmëri në momente e probleme të caktuara.

Kështu gjatë monografisë vihet në dukje ndonjë mangësi trajtimi në krahasim me arritjet e sotme të psikologjisë shkencore, një farë ngushtimi a kufizimi të objektit të psikologjisë, ndonjë mangësi në trajtimin e funksioneve pasqyruese të psikikës, ndonjë moment lëkundjeje lidhur me natyrën e njeriut apo shfaqje të inkosekuencës filozofike që lidhej edhe me faktin se H.Tahsini nuk është plotësisht i lirë nga botëkuptimi dhe nga pikëpamjet fetare. Një gjë e tillë ka rritur karakterin dhe nivelin shkencor të monografisë dhe njëherit dëshmon qartë për seriozitetin dhe objektivitetin e autorit të saj.

Monografia e Prof.Dr Nuri Abdiu mbi psikologjinë e H.Tahsinit është një mesazh, përbën një apel për intelektualët shqiptarë, për rininë tonë që të rendin pas dijes, pas shkencës, pas të së vërtetës, me guxim e vetëmohim, për t'i vënë ato në shërbim të atdheut, të shoqërisë, synimeve e përpjekjeve për demokratizimin dhe europianizimin e Shqipërisë.

Prof. Dr. Nuri Abdiu, me monografinë që paraqet i bën një shërbim të rëndësishëm një rrethi të gjerë lexuesish e studiuesish, jo vetëm të fushës së psikologjisë por edhe të filozofisë, të sociologjisë, të gjuhësisë e të kulturës së popullit tonë, përgatitjes profesionale e ngritjes së kulturës psikologjike të mësuesve tanë. Aq më tepër sot, me rritjen e botimeve psikologjike, me ngritjen e degëve universitare të përgatitjes së psikologëve të mirëfilltë dhe organizimin e studimeve pasuniversitare në këtë fushë, ajo do të shërbejë për formimin më të mirë shkencor e psikologjik të të gjithë atyre që duan t'i përkushtohen psikologjisë, dijeve e kërkimit psikologjik.

Me rastin e 90 vjetorit të vdekjes

Don Nikoll Kaçorri, Nënkryetar i Qeverisë së Vlorës 1912

Nga SALI AJAZI



Historia nuk i harron personalitetet e kombit të çdo vendi. Për ne shqiptarët, pas 25 vjetëve të shtetit të Skënderbeut, arritën të ribëhemi shtet i shqiptarëve nën drejtimin e Ismail Qemalit të Nikoll Kaçorrit, të Vehbi Dibrës e Luigj Gurakuqit me shokë.

Don Nikolla gjatë karrierës së tij fetare nga 1904 e deri në fund të jetës së tij 29 maj 1917 ka drejtuar ritet fetare e aktivitetin patriotik vetëm në Durrës. Një kohë relativisht të shkurtër. Nëntor 1912 – mars 1913 (si klerik dhe si politikan). Për më gjatë i kam trajtuar në monografinë e tij të vitit 2002, botuar në kuadrin e 90-vjetorit të pavarësisë.

Në 90 vjetorin e vdekjes, gjej rastin të pasqyroj dy-tre të dhëna të reja të aktivitetit të tij:

Së pari po japim një dokument të ri, për lexuesin e pikërisht atë të 28 qershorit të vitit 1914 i cili thotë:

1. Lidhja "Për atdheun..." që është edhe titulli i këtij dokumenti, tregon se në Durrës u krijua lidhja e sipërme, qëllimi i saj ishte që t'i shërbejë e t'i ndihmojë me këshilla e me mjete të tjera M.T. Mbretit e Qeverisë (është fjala për Princ Vidin (shënimi im) në përpjekjet e tyre për shpëtimin e atdheut nga trazirat e rrezikshme në të cilat ndodhej vendi.

2. Lidhja përbëhet e do të qeverisej prej një këshilli 22 vetësh. Themelues të lidhjes ishin: zotërinjtë Imzot Kaçorri, Dr. Temo Abdyl Ypi, Mustafa Kruja, Dr. Fahri Gjilani, Luigj Gurakuqi, Refik Toptani, Eshref Idhomene Kosturi, Selfi Hamasi, Ahmet Dakli, Shefqet Dajiu, Kosta Paftali, Nuri Vila, G. Cilka Kasneci, Syrja Bojani etj.

3. Kryetar i Këshillit u zgjodh z. Refik Toptani, nënkryetar Kasneci e shkronjës z. Luigj Gurakuqi.

4. Këshilli ka zgjedhur një komision prej 5 vetash që do të ishin organ i tij për të mbaruar qëllimet e vendimet e tij.

5. Vendimet e Komisionit do të merreshin me vota të plota, jo më shumë se katër veta, ndryshe çështja do të hidhej në Këshill.

E fundit, shokët e këshillit mund të shtoheshin dhe ato do të propozoheshin nga themeluesit e do të zgjidheshin nga këshilli, si të rinjtë do të kishin të drejtë të propozonin ndryshimet e pikave themelore të programit.

Çështja e dytë që dua ta evidentoj në këtë përvjetor, është 21 shkurti 1914. Kur delegacioni shqiptar shkon në Vjenë për t'i dorëzuar kurorën Princ Vidit. Aty morën pjesë: E. P. Toptani kryetar delegacioni, Dom N. Kaçorri, Dr. Xhemil bej Vlora, Spiro G. Koleka, Shefqet Vërlaci, Laf Nasi, Hasan Prishtina etj., gjithsesj 22 vetë.

Në librin "Historia e popullit shqiptar 1912-2007 e autorit Katriot Dervishi thuhet: "Mbeti Princ Vidi u nis për Shqipëri, kaloi në Trieste, aty u prit më 5 mars jo vetëm nga autoritetet Austro-Hungareze, por edhe nga mjaft shqiptar të ndodhur atje ku spikati Don Nikoll Kaçorri.Mëngjesin e 7 marsit 1914 (vazhdon autori K.D.) çifti mbretëror mbërriti në Durrës".

Së fundi dua të trajtoj me respekt, veprimtarinë e priftit të sotëm të Durrësit, Monsinjor Damian Kurti. I nderuari në fjalë mirëpriti monografinë e Don Nikollës, i bëri një vend të përshtatshëm ekspozimi. Më shprehu urimet e falënderimet e përzemërta për këtë iniciativë e shumë prej librave të Dom Nikollës i përcolli për në Kosovë (nga ku është edhe vetë).

Realizoi me iniciativën e tij, vendosjen e bustit të patriotit Kaçorri në lulishten ballë për ballë postit të Durrësit. Bust të cilin e sponsorizoi me të ardhurat e kishës. E porositi me iniciativën e tij, gjithashtu i organizoi edhe ceremoninë e promovimit të tij. Morën pjesë personalitete lokale e klerike të Durrësit, si dhe ... e të afërm të Kaçorrit.

Skulptori Qazim Kërtusha shprehu edhe ai konsideratat dhe kënaqësinë që ndiente në përfundimin me sukses të bustit të këtij patrioti të mirënjohur të të gjitha kohërave.

Prifti në fjalë mbajti meshën kushtuar Dom N. Kaçorri për shpirt të tij. Për të gjitha këto gjej rastin ta falënderoj përzemërsisht Mon sinorin kosovar, për të gjitha çka bëri e do të bëjë për kolegun e adhuruar të tij.

"Kaçorri është dalluar në të gjitha rastet për mendje të kthjelltë, vullnet të fortë, fjalë të mençura dhe të ëmbla, siç ia donte zanati. Këto cilësi i shpalosi, veçanërisht në kuvendin historik të Vlorës 1912. Kudo ndriti duka e tij si në pari të vendit në kishë si klerik, ashtu edhe në krenë të Shqipërisë e të diplomacisë, duke i bërë nder vendit e kombit të vet".

Bash për këto cilësi regjimi turk shkoi, deri atje, kundër tij ia arriti ta burgosë në Jedikule.

(Citimi është marrë në "Hylli i Dritës", nr. 1, viti 1942, f. 17)

NJOFTIM

Gazeta "Rruga e Arbërit", njofton të gjithë lexuesit dhe bashkëpunëtorët, se numri i radhës së gazetës do të dalë çdo të diel të fundit të muajit. Për abonimet dhe shpërndarjen e gazetës në adresën tuaj, duhet të telefononi në numrin e telefonit: **(04) 357 179 / 233 283,** ose të na shkruani në **E-mail: lid_gazeta@yahoo.com**

Reklamoni biznesin tuaj!

Gazeta "Rruga e Arbërit" vë në dispozicion hapsirat e nevojshme për reklamën tuaj!

XHAFER MARTINI BOTON TË RIPUNUAR "KANUNI I DIBRËS"

GJENEZA E CIVILIZIMEVE KANUNORE



Nga Agron TUFA

"Kanuni i Maleve të Dibrës" vjen si dëshmia më e madhe dhe më e plotë e tipologjisë së civilizimeve lokale shqiptare. I njëkohshëm dhe i barabartë për nga rëndësia me "Kanunin e Lekë Dukagjinit "dhe me "Kanunin e Skënderbeut "(me variantet dhe invariantet e tij), -"Kanuni i Maleve të Dibrës" ka të përbashkëta dhe dallime nga dy të parët. Më hollësisht këto dallime do t`i gjeni në "Hyrjen "e mbledhësit të këtij Kanuni, shkrimtarit dhe kulturologut të mrekullueshem, Xhafer Martini.

Gjeneza e sistemeve etnokulturore ku mund të shpiem çdocilën bashkësi, të formuar sipas principit territorial, përfshin fazat e shfaqjes së faktorëve dhe fatin e një grupi njerëzish të lokalizuar në një territor të caktuar. Mandej këta faktorë stimulojnë ngritjen e niveleve të bashkëveprimit të tyre kolektiv. Ky bashkëveprim kolektiv shprehet para së gjithash, në grumbullimin e një përvoje historike të veçantë gjatë veprimtarisë së përbashkët jetësore; shprehet në akumulimin e kësaj përvoje drejt vlerave, realizimin e vlerave dominuese në vetorganizimin social, me tiparet e mënyrës së jetesës dhe tablonë e botëpërceptimit e, së mbrami, me reflekset e këtyre tipareve, të grumbulluara në fazat e mëparshme të etnogjenezës si dhe me transformimin e tyre në identitetin kulturor brendanacional. Një model të gjenezës së këtyre sistemeve etnokulturore ndër ne paraqesin Kanunet. Zanafilla dhe formësimi i mekanizmave juridikë vetëqeverisës, që u dhanë Kanuneve atë fizionimi autentike që njohim(me gjithë të përbashkëtat dhe dallimet mes vedi), është Misteri i Madh që mbështolli embrionin e ekzistencës së pandërprerë të shqiptarëve. Ligjësitë e këtij misteri historik janë mekanizmat pranues/përjashtues të disa kodeve morale e civile sipas arealesh kulturore të veçanta, që gatisnin një homogjenitet etnopsikologjik të ri shqiptar ndaj sfidash të reja, një përjetim të ri në hapësirat prore të ndryshueshme të etnive ndërballkanike, migrimeve të çoroditura dhe kanosjes gllabëruese të hapësirës kulturore të "tjetrit". Kjo zanafillë bart jehonën e të drejtës së lashtë greko-romake, duke u dhënë kanuneve shqiptare natyrën e civilizimit apollonik, sipas O. Shplengerit.

Tanimë kur lexuesi merr në dorë njërin prej tre monumenteve origjinalë të vetëqeverisjes popullore -Kanunin e Maleve të Dibrës - kemi të drejtë t'i referohemi nocionit të arealeve kulturore, që ka shumë të përbashkëta me civilizimet lokale të A. Tojnbi (1889-1975). Intrigues është fakti se këto areale kulturore apo civilizime lokale zhvillohen paralel mes vedi dhe kanë të përbashkët dominanten e Kanunit si formë të vetorganizimit shoqëror. Po cili është ai substrat kulturor-historik që ka provokuar t'i gjegjet paradigma tradicionale e kanuneve në Shqipërinë e Veriut? Sepse baza më e qëndrueshme për dallimin e një organizimi kulturor autentik është specifika e përceptimit /receptimit të hapësirës kulturore e jona / e huaja ose e parafenomenit kulturor. Thelbi i njerëzimit qëndron në shkrirjen mikro-dhe makrokozmosit, prandaj dhe formësimi i kulturës njerëzore kalon nëpër disa etapa evolutive (të karakterizuara nga koha, ritmi i fatit, frika dhe epshi). Kësisoj historia është proces i tëhuajësimit të njeriut prej natyrës organike, "denatyralizimi" i tij; gjakimi për kah njëfarë uniteti organik shpie drejt shkrirjes në popull të "mikro dhe makrokozmosit" individual si baza e parahistorisë. Mikro dhe makrokozmosi i individiumit në Kanun vendoset në korniza mjaft të rrepta, nën kontrollin e strukturave më të thella të së drejtës kanunore dhe vetëdija e individit paraqitet, më së pari, si vetëdije pikërisht e kolektivitetit në Kanun. Edhe ndëshkimi më i ashpër në raport me këtë kolektiv është përzënia prej tij. Atëherë e përsërisim pyetjen: çfarë baze historike (mbihistorike), çfarë parafenomeni i ka paraprirë këtij civilizimi kanunor ndër gegët e Shqipërisë? Dhe, prej nga vjen energjia sakrale e kanuneve që u imponohet po njëlloj të gjitha shtresave të shoqërisë? Po t'i referohemi filozofisë së historisë, Xhambatis Viko (1668-1774) thotë se: "Specifika e 'brendësisë' së historisë së çdocilës epokë varet nga veçoritë "morale "(me këtë të fundit Viko nënkupton jo vetëm sistemin moral e tradicional të jetës së një kombi, por edhe atë ekonomik), ligjet e së drejtës, format e qeverisjes dhe mundësitë e legjitimitetit të së drejtës, komunikimi ndërpersonal dhe stereotipet karakteristike të të menduarit. Së këndejmi, në përputhje me realitetet shqiptare, kur është lëshuar "thirrja"(apeli) - është shpërfaqur edhe impulsi fundamental historik i kundërvënies përballë shpërbërjes dhe tjetërsimit - pra, përgjigjia e mishëruar në Kanunin (e Lekëve, Skënderbeut, Maleve të Dibrës etj.) . Kësisoj, hapësira kanunore ka qenë e determinuar të përftohet e të legjetimohet si dialog i opozicionit binar thirrje/ përgjigje. Një nga përfaqësuesit më të mëdhenj të "filozofisë së jetës", Osvald Shpengler (1880-1936), e hedh poshtë eurocentrizmin tradicional ku historia zhvillohet në mënyrë linjore sipas skemës "Antikitet-Mesjetë -Kohë e Re "dhe e cila ngadhnjen me triumfin e intelektit europian. Kultura dhe civilizimet, sipas Shpenglerit, janë të mbyllura hermetikisht në vetvete, janë organizma monadike me një strukturë "tejpërshkuese" dhe që mundësojnë vitalitetin dhe unikalitetin e tyre. Mendoj se pikërisht, në kordinatat e kësaj skeme të Shpenglerit rri mirë modeli vetëqeverisës i Kanunit të gegëve. Ky civilizim i mbyllur dhe i zbatuar ndër zona, ku më pak e ku më shumë të konservuara, hermetikisht të mbyllura në vetvete, sikundër paraqiten, për shembull, trevat (dhe dialektet) e Dibrës, nuk ka lidhje dhe nuk duhet parë në rrafshe krahasuese me paradigmat e tjera të civilizimit në Kontinent e as në Gadishull, për të gjetur mandej mangësi apo epërsi krahasuar me to. Kanuni është i vetëmjaftueshëm dhe aq i përsosur në funksionin e vetrealizimit dhe të ekzistencialitetit të tij, sa të jetë njëkohësisht krejt i huaj për çdo lloj marrëdhëniesh krahasimore. Nëse marrim të flasim, për shembull, për një paradigmë krahasimore të Kanuneve shqiptare në shumësinë e vet, nuk do të gjejmë analogji të ngjashme ndër popujt e Ballkanit dhe të Europës. Kjo na bën të mendojmë se Kanuni është produkt i epokës së sjelljes postkalorsiake në ndryshim nga kodi etik i nderit dhe i lavdisë që karakterizon epokën heroike të mesjetës së hershme, - kohë që përkon me ngjizjen dhe formësimin e epeve nacionale. Ngjashmëritë dhe analogjitë që mund t'i gjejmë me shumicë në kodin kalorsiak të nderit dhe lavdisë në epet e hershme mesjetare - janë të shumta dhe paracaktojnë tipologjinë e sjelljes heroike kalorsiake. Kryesisht këto ngjashmëri kanë të bëjnë me nocionin e nderit karakteristik kalorsiak dhe i gjejmë si në eposin e Kreshnikëve shqiptarë, ashtu edhe ne epin bizantin të Digenis Akritasit, sikundërse edhe në eposin serboboshnjak e deri në epin rus "Fjalë për fushatën e Igorit". Etika mesjetare është në të njejtën kohë edhe dogmatike, edhe individualiste - e fundit është në atë masë, sakur i duhet njeriut të gjakojë për kah ideali i pambërritshëm. Tipari specifik i sjelljes kalorsiake është maksimalizmi. E rëndomta nuk vlerësohet. Ligjësia e epeve kërkon një hero të jashtëzakonshëm në rrethana të jashtëzakonshme, pra një strukturë krejt tjetër: shkalla më e epërme e idealeve e vlerave (shenjtëria, heroizmi, krimi, dashuria) realizohen vetëm në gjendje çmendurie. * Por duhet patur parasysh që mesjeta e hershme ka njohur dy modele të lavdisë kalorsiake: kishtare - kristiane dhe kalorsiake - feudale. E para qe ndërtuar mbi dallimin e rreptë të lavdisë tokësore dhe lavdisë qiellore me opozicionin dominant "e përjetshme / e përkohshme". Ndërsa semiotika e nderit dhe e lavdisë (namit) në modelin kalorsiako - feudal përfshin detaje të shumta, siç janë shenja e virtytit kalorsiak që shprehet në lidhje me nishanet e shpërblimit, sikundër se dhe shenja shoqërore – lavdia (nami). Këtë mund ta kqyrim në bëmat e heronjve të eposit të Veriut si dhe ndër epet simotra të Ballkanit, para mbishtresës së tyre religjoze. Themelimin e një kodi të ri etik postkalorsiak e ndeshim së pari në kanunet shqiptare, si ndër ato qytetare paraosmane, ashtu edhe në funksionin shenjor stoicist brenda autonomisë osmane. Në fakt me funksionimin e Kanunit kemi refuzimin e kodit kalorsiak në të mirë të themelimit të bazës shoqërore dhe, rrjedhmisht, nënshtrimin e gjithçkaje sistemit juridik të sanksionimeve ligjore, rregullat e të cilit janë fiksuar nga "senati i Pleqeve dhe Stërpleqve". Pleqësia shqiptare e kishte të freskët në vetëdije që në momentin e ngjizjes, energjitë e dobishme të organizimit social të kanunit, pasi vetë e kishte provuar në kurrizin e vet forcën e imponuar gjenocide të kanunit të pushtuesve. Por nëse flasim për një parafenomen të Kanunit- atëherë linja e trashëgimisë së tij merr zanafillë ç'prej ligjvënësve antikë, me Likurgun dhe Solonin (theksi i etikës stoiciste e spartane të kolektivitetit në Kanun), me të drejtën romake(me raportet e së drejtës individuale dhe kolektive, me theks hapësirën e individuales) -dhe me statutet e qyteteve shqiptare paraosmane (statutet e Shkodrës, Ulqinit, Durrësit, Drishtit dhe Budvës, të cilat ruhen deri më sot). Është pikërisht ky moment i statuteve qytetare që shënon ndryshime në organizimin e strukturës shoqërore të shqiptarëve-refuzimin nga principi i organizimit social me bazë gjer atëherë "fisin "në të mirë të organizimit social me princip-bazë "polisin". Në ngjashmëri me to, edhe Kanuni krijoi harta të tjera analogjike, duke e zgjëruar sipas simptomash etnokulturore të përbashkëta e duke na dhënë Dinasti ose minirepublika të mirfillta -harta të tëra trashëgimie ku vetërealizohej dinamika e përditshmërisë së gjallë të psikikës së kombit.

* * *

"Kanuni i Maleve të Dibrës" vjen si dëshmia më e madhe dhe më e plotë e tipologjisë së civilizimeve lokale shqiptare. I njëkohshëm dhe i barabartë për nga rëndësia me "Kanunin e Lekë Dukagjinit "dhe me "Kanunin e Skënderbeut "(me variantet dhe invariantet e tij), -"Kanuni i Maleve të Dibrës" ka të përbashkëta dhe dallime nga dy të parët. Më hollësisht këto dallime do t`i gjeni në "Hyrjen "e mbledhësit të këtij Kanuni, shkrimtarit dhe kulturologut të mrekullueshem, Xhafer Martini. Këtu vlen të përmend vetëm një veçori dalluese të Kanunit të Dibrës - papraninë (mospërfshirjen) e institucioneve religjoze (kishës e xhamisë) duke mos privilegjuar e favorizuar në sanksionet kanunore as klerin. Nga ana tjetër, përpos barazisë së rreptë të rregullit, të cilit duhet t`i nënshtrohet gjithkush njëlloj, pa dallim, -Kanuni i Dibrës spikat për një elasticitet më human e vetëpërmbajtje më të thellë në shumë çështje "të nxehta "si "Gjakmarrja", "Hakmarrja", "Gjaku", "Xhipi"etj.

Një tjetër "avantazh" i këtij Kanuni është sasia e bollshme e fakteve, detajeve dhe e rrëfimeve të vërteta që ballafaqohen e pranëvihen gjegjësisht me tabutë e sanksionuara dhe përkufizimet e së drejtës, duke i dhënë Kanunit dimension të gjallë sintetik. "Kanuni i Maleve të Dibrës" është dëshmia monumentale e asaj "Atlantide" civilizimi të kredhur në memorien dhe etnopsikikën e dibranit. Jehona dhe energjia pozitive e kësaj "vatre civilizimi" dërgon impulset veta sipas ligjësish të ndërdukshme në momente krizash e gjëmash sociale. Vigjilenca intuitive dhe ndjeshmëria e komunikimit me këtë kod të lashtë etiko-social, lyp, para së gjithash, të jesh një recipient jo banal, përkundrazi: ta përceptosh veten në epiqendër të interferencës së këtyre valëve me urtësi mijëvjeçare dhe të dish ta transfigurosh këtë trashëgimi të vyer sipas një evolucioni "krijues" ndërpersonal.

** Jurij Llotman: Kultura i vzryv, kap. Budallai dhe i çmenduri, fq. 80-81("Zakonik Cara Dushana shek. XI-XII)*

VISARE NGA ODA DIBRANE / FJALË NË SEPETE

Mos e fut drithin në thes të huej



Nga NAIM PLAKU

Ato ditë të fundit të atij marsi dimri po ikte duke qarë dhe pranvera zbriste nga bjeshkët duke qeshur. Dimrit, si zakonisht, katundi zbrazej nga burrat, që merrnin rrugën e kurbetit dhe mbetej vetëm ndonjë plak apo ndonjë fodull që vinte shishanen [1] krahëqafë, mbushte kollanin me strajca të vogla lëkure plot barut e eshkë e rrallë e tek kthehej nga pylli me një lëkurë dhelpre a një lepur të vrarë. Hynte në katund gjerë e gjatë duke lëmuar mustaqet spic.

Pasi binte dielli i vakët dilnin gratë nga shtëpitë dhe nisnin punët e tyre të përditshme.

Kështu bëri edhe Lemja, nuse shtatë dimrash në kadundin Lekas, me tre fëmijë e një barrë halle mbi shpinë, që priste majn t'i kthehej burri nga Selaniku, ku dimëronte çdo vit. Kishte ushqyer gjënë e gjallë, kishte pastruar shtëpinë, kishte mbledhur rrobat e palara dhe, pasi kishte porositur vajzën e madhe pesëveçare për fëmijët që akoma flinin, kishte dalë tek burimet poshtë për të larë si zakonisht teshat. Kur po ndizte zjarrin për të vënë kazanin e finjës bëri bef Dine Kola, burrë dyzetësh që s'e hante kurbetin, por sillej si dash kumbore e ia kishte ënda ta cokte muhabetin me gra të ngeshme e të bëshme.

-A ke sapllake me vete, oj nusja e Zhup Arres?

-Jo nuk kam, - ia preu shkurt Lemja pa e kthyer kokën nga ai.

-Nuk pin burri ujë në currila, oj nusja e Zhupës, - dhe lëpiu mustaqet e përpiu me sy kurmin e bukur të asaj nuseje të re,që nja dy-tre herë e kishte bezdisur me ca romuze dashurie, por ajo më e rënda për Lemen ishte e disa ditëve më parë që, teksa mbante në krahë djalin dyvjeçar që po buzëqeshte në gjoksin e nënës, iu afrua Dine Kola e filloi ta puthte e ta përkëdhelte. Lemja u shmang dhe i foli ters:

-Ky djalë e ka një babë, o Dine Kola. Konakun s'e ka bosh. Shif në sheme [2] e brenda, se po shikove havanë, zë në thua e të zë gjak hunda.

-Konak kam, por s'më bën dritë. Pastaj, oj nuse... kali i mirë e shton tagjinë.

-Tagjinë e shton, por në hambar të vet. Po më vjen keq, o Dine Kola, se po i shkret sinorët e Kolëve, - tha me një zë të prerë e burrëror Lemja duke mbyllur me forcë derën e avllisë. Nga prapa derës së madhe Dinja i mbetur e mbytur me djersë të ftohta dëgjoi një zë të përzier me një psherëtimë:

-Çapa e sokakut…[3]

Lekasi atë ditë u zgjua me gjëmë. Te sinori i arës së Dines erdhën dy të rijnë dhe e ngritën trupin e gjakosur të burrit dyzetësh dhe mes vajit e kujeve të grave hynë në konak dhe e shtrinë në mes të vatrës. Gjëma e grave nisi dhe konaku i Dines filloi të mbushej me burra.

Heshtja përzihej me një farë kureshtje të hidhur, se cila ishte dora vrastare, deri sa nga fisi Arra erdhi një lajm:

-Kolë, morë, Kolë! Mos u mundo ta derdhësh drithin në thes të huaj!

Konaku heshti! Gjama paksa pushoi.

Në odën e grave me trarë të nxirë, në një shtrat hasre [4], mbi një lëkurë dashi i mbuluar me një pëlhurë të verdhë e të arnuar vendevende ishte shtrirë trupi i Dine Kolës i rrethuar nga gratë vajtoca. Te koka i qëndronin motrat, te këmbët, mes disa grave të fisit të vet, qëndronte gruaja, një fatkeqe, kishte ardhur në këtë derë kur ishte gjashtëmbëdhjetë. Dukej e plakur, e mërzitur dhe me duar të përzhitura e të anjtura, siç duket nga punët e shumta të shtëpisë që kishte bërë tërë jetën.

Në krah të motrave mori vajin vajtoca Mude:

Ishe bash si lisi rrit në reshta,
o mor vllau jem!
Ishe bash si dashi ndër të leshta,
o mor vllau jem!
Ishe porsi gjarpni me dy krena,
o mor vllau jem!
Dilshe, por s'të hyhej mrena,
o mor vllau jem!
Ishe burrë me sedër e adete,
o mor vllau jem!
Se çdo burrë don eshin [5] e vet,
o mor vllau jem!
Hike pa bilur e pa hismet,
o mor vllau jem!
Hisen që t'la baba mbeti shkret…
o mor vllau jem!

Në krah të gruas që rrinte kërrusur si ndonjë fajtore pa faj e mori vajin vajtoca Bide:

Kush të vrau, Dine, iu thaftë dora,
Dëgjo vlla, se ç'po të thotë motra,
Ky konak ty s'të bante dritë,
Tjetërkund, oj shtupe [6] i hodhe sytë,
Fatin tan me lot e ke mulue,
Hall e derte sot na i ke trazue,
T'patëm thanë me ferrën mos u kruej,
Farën mos e hidh në arë të huej!
T'patëm thanë, por nuk vune men
Thotë katuni na fugjni çat çen!
Kur të shkojsh n'mullaj për me gjuj [7],
Mos e fut kurrë miellin n'thes të huj!

Vargjet ndiqnin si replika të fuqishme grupet që përfaqësoheshin secila me vajtocën e vet, që ishte një lloj poeteshe, ku secila mbronte në podiumin e mortës, para arkivolit pikëpamjet e veta.

… Por Dine Kola hyri në varr, arat i mori Arra, se hisja u shkret e u varros për të mos u ngjallur më.

---

1. Shishane = lloj arme me mbushje baruti.
2. Shemë-a,at,em = pragu i derës.
3. Çapa e sokakut = qen rrugësh, zagar, zakite.
4. Shtrat hasre = shtrat i bërë me kashtë.
5. Eshin-i,e,em. = njeri i ngjajshëm, që shkojnë me njëri tjetrin në pamje e zakone.
6. Hike pa bilur… - ike nga kjo botë pa u kënaqur.
7. Shtupë = bosh

Ngjarjet e rëndësishme regjistrohen në mendje e nuk harrohen

Shoqata "Lidhja e Intelektualëve Dibranë" organizoi promovimin e librit të Dr. Hasan Lekës "Në rrjedhë të jetës"

Nga Dr. VEIP PRODA

Më datën 25 prill, në një nga sallat e Qendrës kulturore "Pjetër Arbnori", Shoqata "Lidhja e Intelektualëve Dibranë" organizoi promovimin e librit të Dr. Hasan Lekës "Në rrjedhë të jetës".

Fjalën e rastit e mbajti kryetari i shoqatës Prof. Dr Nuri Abdiu.

Diskutantët e shumtë vlerësuan autorin për këtë botim dinjitoz, i cili, edhe pse është me kujtime, ka të veçantën e tij. Rreth librit folën shokë dhe miq të autorit, kolegë të punës që kanë punuar vite me radhë, bashkëfshatarë, por dhe njerëz të afërm nga rrethi familjar. Libri trajton ngjarje nga më të ndryshmet që ka kaluar autori, që nga bankat e shkollës e deri në detyrat e larta që i janë besuar në ato vite. Autori flet për ngjarje të bukura që lidhen me vendlindjen, për festat pagane e fetare, për toponimet dhe folklorin aq të pasur, për veshjen dhe zakonet e vendlindjes së tij. Dr. Hasan Leka nuk e harron realitetin e atyre viteve, kur varfëria ishte ulur në vatrat tona, kur boja e kinxhlave dhe bishti prej shtogu ishin mjete pune për nxënësit e shkollës, për dimitë e hallës të arnuara që nuk u gjendej origjinali. Hasani ka përdorur një gjuhë të ëmbël, të pastër dhe ndaj libri lexohet shpejt. Në fund, për të pranishmit u dha edhe një koktej, si dhe u shpërnda falas gazeta "Rruga e Arbërit".

Autori, i cili është njëkohësisht një shok i vjetër imi i punës dhe një komshi i mirë dhe i urtë, na vjen me një libër kapital për llojin e tij dhe tematikën që trajton. Është kapital dhe i veçantë, sepse kapitale dhe e veçantë është familja e ngushtë dhe fisi Leka dhe më gjerë: fshati, rrethi. I veçantë si person është edhe vetë Hasani. Domethënë, neve kemi në duar një histori të një personi, të një familje, të një fisi e më gjerë, por të lidhura me këta.

E veçanta qëndron, ndërkohë, edhe në atë se ngjarjet, evenimentet e individit, familjes a fisit dallojnë nga ata të të tjerëve, qoftë edhe në elementë specifikë, dhe, së fundi, pikërisht për këto, neve kemi në dorë një histori, një gjenealogji, një vijë uji në historinë e gjerë lokale, krahinore, kombëtare. Edhe vetë titulli i librit e vërteton këtë.

Libri i Hasan Lekës "Në rrjedhë të jetës" është një dokument autentik, në formën e dëshmisë dhe si i tillë ka vlera edhe më të mëdha.

Atje janë ato të pathënat e derisotme, të cilat më të shumtën e herës ikin së bashku me bartësit e tyre, duke lënë një vakum, një pikëpyetje, një enigmë. Shpeshherë kemi thënë se shekujt e kaluar, sidomos ato të mesjetës , janë të errët në historinë tonë kombëtare.

Kërkojmë e citojmë ndonjë udhëpërshkrues, ngaqë neve ose na i kanë zhdukur, ose vetë zhdukur letrat, siç kemi jo pak herë edhe sot, ose nuk kemi hedhur të zezën mbi të bardhën , siç kanë bërë kombet e tjerë; të cilët e kanë shtrembëruar të vërtetën, kur kanë parë se neve kemi qenë të përfshirë në të tjera interesa, siç jemi edhe sot, fatkeqësisht!

Edhe mbi bazën e këtij kënd shikimi Hasan Leka vlen të falënderohet. Libri i tij do të citohet nga brezat e ardhshëm, sa herë që do të trajtohen probleme, për të cilat flitet në libër. Prandaj kujtimet, memoaret hyjnë në letërsinë dokumentare dhe si të tilla kthehen në arkiva me rëndësi kapitale për një komb, aq më tepër për kombin tonë të copëtuar "progresivisht" në gjashtë shtete.

Hasan Leka ka kaluar në shumë sektorë të sistemit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, duke e treguar veten kuadër të përgatitur, vigjilent, besnik i atdheut dhe i kombit. Ai ka shërbyer atje ku i kanë kërkuar dhe gjithmonë ka dalë me nder dhe faqebardhë. Për më tepër se një dekadë ai ka qenë drejtues në sektorin e studimeve dhe të disertacioneve në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Kjo do të thotë se është një punonjës shkencor, që njeh metodologjinë e studimit, parashtrimit dhe realizimit të një vepre, siç është edhe libri që kemi në dorë.

Nisur vetëm nga ky fakt, unë pa e lexuar ende librin, e kisha të qartë se kisha të bëja me një punë metodologjikisht të drejtë dhe me platformë të qartë në shkruarjen e ideve, në përshkrimin e ndodhive dhe në nxjerrjen a evidentimin e përfundimeve, të gjitha këto në për puthje me synimet e qëllimet e shkrimit dhe botimit të këtij libri. Dhe s'isha gabuar.

Nga libri mësova shumë, njoha shumë gjëra të panjohura dhe u afrova dhe u njoha më shumë me doket e zakonet e krahinës së nderuar të Dibrës. Autori na thotë një të vërtetë të madhe: "Ngjarjet e rëndësishme regjistrohen në mendje e nuk harrohen"!

Kjo ndodh me individin, me bashkëkohësin, por jo me brezat, të cilat duan t'ua lësh të dokumentuara ato ngjarje, ndryshe jo vetëm që harrohen, por edhe shtrembërohen. Shikoni se çfarë ndodh për shembull me gjakmarrjen: kodet e kanunit, një dokument shumë i rëndësishëm për kohën kur ai lindi, sot është degjeneruar. Shqiptari në kohën e pushtimit osman, në shumë krahina ruante autonominë lokale a krahinore dhe marrëdhëniet e tij me portën ishin dimensionale: jepte xhelepin dhe nizamët. Duke qenë jashtë kanuneve të dovletit, duhej të ishin nën një "hyqëm" të rreptë, ndryshe gjithçka mund të ndodhte, duke filluar nga rregulli e deri tek besnikëria! Erdhën kohët që kanuni duhej të arkivohej dhe u arkivua. Por, tashmë, doli përsëri tragjikisht në skenë në një mënyrë tjetër perverse. Me të drejtë autori shkruan: "Kish rregulla të forta për gjakmarrjen e jo si sot kur vret këdo në fis, bile nga më të mirët, burra e djem të fisit, e, aq më keq, kur për turp vriten gra e fëmijë, që nuk kanë vënë edhe pushkë në krah"!

Kampioni që krenohet me vendlindjen!

Në ndeshjen finale për titullin Kampion bote në Tai dhe Kik Boks, Ismail Keta nga Bulqiza paguan një austriak për t'i mbajtur flamurin shqiptar në pallatin e sportit ...



Nga DEFRIM METHASANI

Ekam njohur disa vite më parë, atë vit kur ai shpallej nënkampion bote, në një sport që në Gjermani është shumë i njohur. Quhet Ismail Keta dhe atje thirret Xhoni. Një djalë me një trup për ta pasur zili, që ka ditur të fitojë jo vetëm në ring, por edhe në përbal1jen me jetën. Në vitin e vështirë të '97, djali nga Koçaj i Bulqizës, merr rrugën e kurbetit, drejt Greqisë. Trupi i tij i formuar nga muskujt bie në sy të pronarëve, të cilët e vlerësojnë për forcën dhe karakterin dhe i ofrojnë punë të tilla që mbronin qetësinë e lokaleve apo pronave. Në televizor, shpesh e tërhiqte sporti i Kik dhe Taj Boksit, ndaj vendosi ta ushtrojë. Por ishte e pamundur në Greqi, pasi duhet të ishe atje ku ky sport kishte vlerë. Dhe vendos vetë për ta realizuar këtë ëndërr. Udhëton drejt Gjermanisë dhe pas pak vitesh arrin në finish. Në vitin 2000 ai realizon këtë objektiv dhe shpallet kampion i Gjermanisë, duke e ruajtur titullin për disa vite me radhë, tashmë në sportin profesionist. Këtu u bë shpejt një fenomen në dhe kulmi erdhi në vitin 2004, kur edhe fitoi titullin nënkampion bote. Në ndeshjen finale dikush duhet t'i mbante flamurin. Asnjë shqiptar nuk kishte në pallat të sportit, ndaj vendosi të paguante një tifoz austriak për ta mbajtur simbolin e atdheut të tij. Dalëngadalë, krahas të qenurit sportist, atij i lindi dëshira të ishte edhe trajner e mësues i mirë. Falë guximit profesional, por edhe të ardhurave që siguronte me sportin dhe punën e tij, ai realizon një tjetër ëndërr, atë të një shkolle private sportive. Në Mynyh ka dy vjet që ka ngritur një shkollë gjigante. Afro 100 fëmijë gjermane dhe të kombësive të tjera i kanë besuar atij të ardhmen e fëmijëve në sport. Kur e pyet se a do të bëhen të gjithë sportistë të zotë, ai të përgjigjet: "Të paktën, dua t'i bëj njerëz, sepse duke u marrë me sport, ata eliminohen nga rruga dhe veset..." Është ky një mësim i madh që vetëm njerëz të tillë mund ta japin. Tashmë, në krah Ismail Keta ka edhe vëllain, Xhetanin, i cili është një nga sportistët më të mirë në Gjermani, duke trashëguar cilësitë më të mira të vëllait. Ismail Keta tashmë ka një mision të ri, që këtë sport ta sjellë edhe në Shqipëri, ndërsa vazhdon të përgatitet edhe vetë, në kërkim të titullit kampion bote dhe Medaljes së Artë për Shqipërinë në lojërat olimpike të Pekinit.

Detyra ime si gazetar më ka krijuar mundësinë e njohjes, madje edhe të familjes së tij në fshatin Koçaj të Bulqizës. Në atë kullë të bardhë dhe të bukur, mes natyrës piktoreske, kam gjetur thasët me rërë, litarin dhe rrotat e vagonëve ku ai bënte stërvitje kur ishte fëmijë dhe në moshë të re. Aty pashë që ky djalë nuk u bë kampion rastësisht, por falë pasionit dhe përkushtimit brilant që kishte. Pjekuria e një njeriu me përmasa të tilla, vlen të përmendet. Ai është kthyer në një "ambasador" të vërtetë për gjithë ata që vizitojnë qytetin ku banon. Njihet dhe respektohet nga të gjithë. Doktor Sami Koçeku, profesor Gafurr Muka apo biznesmeni Qemal Disha, të flasin me superlativa. Por jo vetëm ata. Ai vlerësohet dhe respektohet nga të gjithë. Luan Krasniqi është një nga miqtë e afërt të tij, sepse përveç vlerave në sport këta dy njerëz i bashkon edhe një dashuri: ajo ndaj vendlindjes dhe atdheut, njerëzve dhe miqve të tyre. Disa herë kam udhëtuar me të në Tiranë, por edhe në Bulqizë dhe kam parë nga afër, atë çfarë ushqejnë njerëzit për të. Është tepër i thjeshtë dhe duket se madhështinë dhe forcën e ruan vetëm në kuadratin e ringut të boksit. Në një emision në TV Bulqiza, një telefonues bëri edhe një propozim për ta shpallur "Qytetar Nderi". Vërtet, njerëz të tillë e meritojnë një shpërblim moral, pavarësisht kupave e trofeve që fitojnë në sport. Të jesh sportist është njëra anë, por të mbetesh njeri është pjesa më e rëndësishme. Edhe në spektaklin e 10 sportistëve më të mirë në fundvit në Tiranë ishte i ftuar nderi. Me modesti ai pranoi të rikthehej në sport, për hir të vendit të tij. Ai tani përgatitet për një turne ndërkombëtar që do të zhvillohet me 29 shtator në Tiranë, në sportin e zemrës që kërkon ta njohë edhe në Shqipëri. Përveç kësaj, ai kërkon edhe gjëra të tjera të bëjë, ashtu siç solli edhe uniformat sportive dhuratë në qytetin e vendlindjes. Kampionë të tillë ia vlen t'i kesh nga vendi ku jeton e banon, veçmas, nga vendlindja. Ata që kthejnë kokën pas, meritojnë respektin e të gjithëve. Ismail Keta, nuk është vetëm një pasuri dhe kënaqësi e babait të tij Asllanit, nënës, motrave apo vë11ezërve,por edhe një vlerë e Dibrës dhe Bulqizës, pse jo edhe e Shqipërisë. Ndaj, të tilla vlera duhet të respektohen e çmohen, sepse ata asnjëherë nuk humbasin, por rriten dhe marrin ngjyrë nga dita në ditë dhe nga viti në vit...

5 BOTIME TË REJA NË FUSHËN E MATEMATIKËS NGA BASHKIM GAZIDEDE





Grafika: **Studio "m&b"**. Tel: (04) **233 283**. Shtypur në shtypshkronjën "**Dita 2000**". Tel: (04) **273 745**